



BASHKIA BERAT

RELACION

**PËR PROJEKT BUXHETIN VJETOR 2026
DHE
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR
2026 - 2028**

Përmbajtja e Plan Buxhetit 2026 dhe PBA Përfundimtare 2026-2028

Mesazhi i Kryetarit të Bashkisë Berat për buxhetin e vitit 2026

1. Hyrje

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

2. Buxheti i Vitit 2026 dhe Afatmesëm i Bashkisë Berat 2026-2028

2.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

2.2 Informacion përmbledhës për përgatitjen e buxhetit të vitit 2026 dhe PBA 2026 – 2028

3. Të ardhurat dhe shpenzimet publike të bashkisë Berat në vitet 2026-2028

3. 1 Plani i të ardhurave në Bashkinë Berat për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028

3.1.1 Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028

3.1.2 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

3.1.3 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

3.1.4 Transferta të Kushtëzuar për funksione të deleguara.

3.1.5 Fonde për Ndihmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore

3.1.6 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

3.2 Plani i shpenzimeve të bashkisë Berat për vitin 2026 dhe periudhën afatmesme 2026-2028

3.2.1 Plani i shpenzimeve sipas ndarjes ekonomike

3.2.2 Buxheti i vitit 2026 dhe afatmesëm 2026-2028 për programet buxhetore

3.2.2.1 Programi AA102 Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse

3.2.2.2 Programi AB102 Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile

3.2.2.3 Programi AC102 Arsimi & Kujdesi Social

3.2.2.4 Programi AD102 Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar

& Siguria Ushqimore

3.2.2.5 Programi AE102 Siguria dhe Mbrojtja e Territorit

3.2.2.6 Programi AF102 Rezerva & Kontigjenca

3.2.2.7 Programi AG102

MESAZHI I KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR BUXHETIN E VITIT 2026

E nderuar zj. Evisa Çela, Kryetare e Këshillit të Bashkisë Berat!

Të nderuar këshilltarë!

Po ju paraqesim për miratim Plan Buxhetin e vitit 2026 dhe PBA 2026- 2028, haruar sipas kriterëve ligjore të legjislacionit në fuqi, vendimeve të mëparshme të Këshillimit Bashkiak dhe udhëzimeve të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Përgatitja e Buxhetit i parapriu dëgjuesat publike, mendimin e komunitetit dhe takimet me grupet e interesit, si edhe paketën fiskale në fuqi, duke pasqyruar kërkesat e komunitetit dhe prioritetet sipas Rajoneve dhe Njësive Administrative.

Gjatë vitit 2025 Bashkia Berat pati një performancë të mirë finaciare dhe të shërbimeve publike që mbulon në territor duke garantuar eficiencë të fondeve të përdorura.

- Grantet e Qeverisë Qendrore për projekte të zhvillimit vendor dhe projektet me bashkëfinancim nga Partnerë të huaj, vijojnë të jenë burimi kryesor i transformimeve në qytet.
- Impakt në zhvillimin ekonomik,ka rritja e qëndrueshme e numrit të turistëve që kanë vizituar Bashkinë Berat.
- Nga pikëpamja e menaxhimit financiar, bashkia ka bërë një progres të ndjeshëm, duke rritur të ardhurat nga burimet e veta.
- Bashkia ka përmirësuar shërbimet e ofruara për komunitetin me anë të një fondi investimesh përmes të cilit janë financuar shërbime të tilla si: shërbimet publike, ndricim publik, gjelbërim,mirëmbajtje arsimit mesëm i përgjithshëm dhe arsimit parashkollor, rrjeti rrugor rural, mbrojtja nga zjarri, bujqësia,trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore, Strehimi Social, Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, etj.
- Bashkia, në bashkëpunim edhe me projektin “Bashki të Forta”, ka ofruar transparencë duke zhvilluar konsultime publike, për çdo akt për të cilin kërkohet me ligj konsultimi publik, si dhe duke mundësuar zhvillimin e të gjitha mbledhjeve të Këshillit Bashkiak të hapura për qytetarët.

Projektet në infrastrukturë të cilat janë implementuar në Bashkinë Berat, kanë bërë të mundur transformimin e qytetit nga pikepamja turistike dhe urbane. Ndër to përmendim:

- Projektin e Urës së Bilçës e cila është një investim madhor që lidhin qytetin me fshatin Bilcë dhe shton aksesin drejt siteve të eko-turizmit;

- Projekti i Parkut Rekreativ “Dua të luaj”, i cili bën të mundur krijimin e një hapësire shplohëse dhe rekreative për aktivitete sportive, fusha sportive dhe ambiente shplohëse;
- Projekti i Sheshit “Teodor Muzaka”, Sheshi i Bashkejeteses fetare dhe rruga Antipatrea,
- Rehabilitimi i Lagjes Mangalem
- Rruga “Shpiragu” që lidh Velabishtin me Goricën, duke përfunduar paketën e investimeve në infrastrukturë rrugore në zonat historike.
- Në vijim presim edhe implementin e dy projekteve që kanë të bëjnë me rrugë akses në Kala “Rruga Shkëmbi” dhe Smart Parking në Kala.

ZONAT RURALE :

- Projekti i rruges se Qafe Dadhes dhe Cesma e Tarikos- Sotire qe sapo ka përfunduar.
- Rruga Sinjë –Mbjeshevë- Cfir që sapo ka përfunduar
- Rruga Bilcë-Drobonik që sapo ka përfunduar
- Ndërtimi i Urës Lapardha 2

Zonat rurale janë mbështetur me investimet në kanalet vaditës dhe kullues, me 88 km kanale te pastruar në katër vitet e fundit, 1885 hektarë sipërfaqe të përfituar, dhe përfitues janë 1980 fermerë.

- Asfaltimet ne Zonat Rurale
- ZIP LINE në fshatin Roshnik

INVESTIMET STRUKTURE:

- Investime në rrjetin e ujësjellës kanalizime në gjithë territorin e qytetit. Qyteti i Beratit mbulohet me furnizim me ujë 24 orë/ditë. 60 % e fshatrave mbulohen me 24 orë/ditë.
- Ndërtimi i rrjetit KUZ në Uznovë dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Kombinat.
- Priten investime në vitin 2026 dy ujësjellsat në Qereshnik dhe Ullinjas.

Në vitin 2026 fillojnë projektet madhore në sistemin e kanalizimeve të ujrave të zeza në gjithë qytetin dhe ndërtimin e Impiantit të trajtimit të ujrave të zeza me standarte të BE, duke bërë të mundur shmangien e ndotjes në Lumin Osum.

- Bashkia Berat ka bërë revolucion në fushën e pastrimit duke ngritur Kompaninë Aksionere Bashkiake “Berat City Green”:
- ✓ Landfill i mbetjeve sipas standarteve
- ✓ Zgjerim me 35% mbulimin e pastrimit në territor
- ✓ Flota e re e mjeteve
- ✓ Është pajisur zona urbane me 1500 kontenierë të rinj të riciklimit
- ✓ Është pajisur zona urbane me 380 kontenierë miks

- ✓ Qendra për riciklimin e mbetjeve pranë landfillit ku trajtohen çdo muaj 85 ton mbetje te riciklueshme.

MOBILIM URBAN:

- Në lagjet e qytetit, janë kryer rehabilitim të rrugëve dhe shtrim me asfalt të lagjeve në 3 Rajonet e qytetit, në total 33 km
- Ndriçimin eficient në 2 rrugë kryesore të qytetit
- Ndërhyrje në sistemin e eficeses sistemi kapot në 5 pallate lagjja “Donika Kastrioti”.
- Rruga Uznovë- Spital
- Rrethrotullimi i Spitalit
- Rehabilitim Urban Sheshi “Jani Vruho”
- Projekti i Tregut të Gjelbërt për produktet e fermerëve.

INVESTIME NË ARSIM DHE PROJEKTE NË FUSHËN SOCIALE :

Berati ofron kushte më të mira për familjet, të rinjtë dhe fëmijët, duke ofruar shërbime komunitare me standarte të përmirësuara:

- Gjimnazi “Babë Dudë Karbunara” dhe shkolla “22 Tetori” që është në ndërtim, janë dy shkollat model , sipas standarteve më moderne.
- Sapo ka filluar ndërtimi i Shkollës Lapardha
- Sapo ka filluar ndërtimi i Qendrës Kulturore dhe Rinore Lapardha
- Janë rehabilituar në mënyrë të pjesshme 4 shkolla, 38 kopshte dhe 4 çerdhe.
- Në total 1315 fëmijë në kopshtet dhe çerdhet e qytetit dhe fshatrave marrin shërbime të përmirësuara dhe sipas standarteve, ndërkohë ofrohet subvencionim me ushqim për 104 fëmijë në kopshte dhe çerdhe dhe baze didaktike për 1100 fëmijë.
- Qendra Komunitare, Qendra “LIRA” dhe “Strehëza” ofrojnë shërbime për 170 persona nga grupet në nevojë.
- Në fushën e strehimit social, mbështeten cdo vit me programe, 98 familje.
- Në Qendrën Rinore e cila ofron aktivitete për të rinjtë ku në tre vite:
 - ✓ Janë organizuar 71 aktivitete
 - ✓ Rreth 300 të rinj pjesëmarrës
 - ✓ Bashkëpunim me 37 Organizata partnere
 - ✓ Kurse profesionale dhe trajnime për inovacionin dhe teknonlogjinë për 34 të rinj.

INVESTIMET NË BASHKINË BERAT KANË SJELLË RITJE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK:

- Në 2024 kishim 1 milionë vizitorë me një rritje 35% duke e krahasuar me vitin 2023.
 - Në 2025 periudha Janar- Tetor 2025 kemi 750,000 turistë.
 - Në vitin 2025 kemi 300 struktura akomoduese, hotele, bujtina, shtëpi pritëse ose 25% më shumë se 2023.
 - Në vitin 2025 kemi 10,000 shtretër në funksion të turizmit.
 - Rritje të vlerës së pronave me 35% krahasuar me vitin 2023
-
- Në funksion të turizmit organizohet edhe paketa e eventeve, ku kemi një stacion datash vjetore të cilat janë kthyer në evente kombëtare dhe ndërkombëtare me rreth 35 mijë vizitorë të pranishëm.

- 1.Festivali i Verës.
- 2.Mangalem Shades
- 3.Christmass Market dhe Festat e Dhjetorit.
4. Maratona e Gjellbërt,
- 5.Festat e fshatrave: Festa e Qershisë,Festa e Fikut në Roshnik, Festa e Ullirit në Bilçë, Festa e Sinjës,
- 6.Festivali Xixëllonjat
- 7.Festivali i Teatrit Kombëtar për Fëmijë,
- 8.Fundjavat e Verës në Berat

Të nderuar këshilltarë,

Buxheti 2026 do të vijojë nxitjen e investimeve në të gjithë sektorët e shërbimeve në Bashkinë Berat, duke synuar që stabiliteti ekonomik dhe social, të vijojë dhe të rriten të ardhurat ekonomike për familjet e bashkisë Berat.

Fokusi për vitin 2026 do jenë mobilimet urbanë në qytet dhe në zonat rurale, projektet në mjedis, transport ekologjik, rehabilitime të shesheve dhe parqeve për fëmijët, rritje shërbimesh për njerëzit në nevojë, rritje shërbimesh në fushën e arsimit dhe rinisë dhe nxitje të sektorit të turizmit.

Ju ftoj ta mbështesni draft projektin e Buxhetit 2026 dhe Plan Buxhetin Afatemesëm 2026-2028, të cilët reflektojnë hapat që bashkia Berat do të ndërmarrë për zhvillimin e Bashkisë së Beratit.

Ju faleminderit,

Ervin CECA

KRYETAR I BASHKISË BERAT

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësinë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësinë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjat' i referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve;

4 Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2026-2028 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanet e përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

Procesi i konsultimeve publike

Në përgatitjen e këtij dokumenti janë zhvilluar dëgjesa publike në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Berat, për të garantuar përfaqësimin e komuniteteve si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Gjithashtu, janë organizuar takime të posaçme me grupe interesi si bizneset, organizatat e shoqërisë civile, mësuesit, stafi shëndetësor, të rinjtë dhe pensionistët, për të mbledhur mendime dhe sugjerime mbi prioritetet buxhetore.

Procesi i dëgjësive është zhvilluar me transparencë të plotë, i dokumentuar me procesverbale, dhe sugjerimet e qytetarëve janë marrë në konsideratë në hartimin e këtij dokumenti. Kjo siguron që PBA 2026–2028 të mos jetë vetëm një planifikim administrativ, por edhe një produkt i përbashkët i qytetarëve dhe bashkisë.

2. BUXHETI I VITIT 2026 DHE AFATMESEM I BASHKISË BERAT 2026-2028

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Berat gjatë periudhës 2026-2028.

Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2026-2028, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit.

Nënseksioni i dytë paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2026-2028. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse.

Tabela 1. Të dhëna mbi Bashkinë Berat

		Të Përgjithshme	2021	2022	2023	2024	2025
1	Numri i Njësive Administrative	7	0	0	0	0	0
2	Numri i Fshatrave	50	0	0	0	0	0
3	Sipërfaqja e NJVQV (km2)	380	0	0	0	0	0
3.1	Qyteti	19	0	0	0	0	0
3.2	Njësitë Administrative	361	0	0	0	0	0
4	Sipërfaqja e NJVQV (km2)	380	0	0	0	0	0
4.1	Zonë Urbane	6.3	0	0	0	0	0
4.2	Tokë Bujqësore	147.64	0	0	0	0	0
4.3	Kullota	36.09	0	0	0	0	0
4.4	Pyje	109.03	0	0	0	0	0
4.5	Të tjera	80.94	0	0	0	0	0
5	Popullsia e NJVQV	0	99,793	99,772	99,739	99,727	99,691
5.1	Qyteti	0	63,408	63,514	63,428	63,376	63,262
5.2	Njësitë Administrative	0	36,385	36,258	36,311	36,351	36,429
6	Mosha Mesatare e Popullsisë	0	40	40	40	40	40
7	Numri i Lindjeve	0	566	376	323	202	338
8	Numri i Vdekjeve	0	691	427	364	300	332
9	Numri i Bizneseve Aktive	0	2,410	2,056	2,301	2,321	2,651
10	Numri i Familjeve	0	34,150	34,471	34,877	35,120	35,434
10.1	Qyteti	0	23,198	23,471	23,688	23,842	23,939

10.2	Njësitë Administrative	0	10,952	11,000	11,189	11,278	11,495
11	Numri i Punonjësve të NJVQV me Kohë të Plotë	0	702	738	787	816	816
11.1	Administrata e NJVQV	0	156	162	170	179	172
11.2	Njësitë Shpenzuese	0	546	576	617	637	644
12	Numri i Punonjësve të NJVQV me Kohë të Pjesëshme	0	6	6	6	8	8
12.1	Administrata e NJVQV	0	0	0	0	2	2
12.2	Njësitë Shpenzuese	0	6	6	6	6	6
13	Numri i Programeve Buxhetore	0	23	17	7	7	7
14	Stoku i akumuluar i borxhit tatimor/detyrimeve tatimore të pambledhura në kohe, ne fund te vitit fiskal	0	0	0	0	0	0
14.1	Vlera e borxhit tatimor/detyrimeve tatimore te pambledhura ne kohe, me e vjeter se 18 muaj (Mijë ALL)	0	0	0	0	0	0
14.2	Vlera e borxhit tatimor/detyrimeve tatimore te pambledhura ne kohe, me e re se 18 muaj (Mijë ALL)	0	0	0	0	0	0

2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE

E shtrirë në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ultësirën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum, Bashkia Berat është një atraksion jo vetëm turistik, por edhe një njësi ekonomike me resurse të mëdha zhvillimi.

Ajo përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ qytetin e Beratit, njësitë: Otlak, Velabisht, Roshnik, dhe Sinjë. Në total nga 5 njësi administrative.

Tregues të rëndësishëm statistikorë bazë të saj janë:

Sipërfaqja: Bashkia Berat ka një sipërfaqe totale 380 km² e cila klasifikohet në tokë bujqësore prej 170 km², (përfshirë këtu tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe tokë natyrore 180 km² (përfshirë këtu pyjet dhe kullotat)

Karakteristika të veçanta kanë njësitë përbërëse të bashkisë pjesë e ish komunave si :

Njësitë Otlak dhe Velabisht të cilat në sipërfaqen e tyre kanë më shumë tokë bujqësore, dhe njësitë Roshnik e Sinjë që kanë në strukturën e sipërfaqes së tyre teritoriale tokë bujqësore të fragmentarizuar me siperfaqe më të madhe të tokës natyrore, dhe reliev kodrinor malor.

Bashkia Berat përshkohet nga lumi i Osumit dhe është tepër e pasur me ujëra nëntokësore e burime ujore sipërfaqësore .

Sipërfaqja totale ujore është 9 km². Sipërfaqet e banuara janë 4.63 km².

Industria dhe ekonomia shtrihen në një siperfaqe prej 1.34 km².

Bashkia përshkohet nga 812 km rrugë

Qyteti i Beratit gjendet 58 m mbi nivelin e detit dhe ka nje sip. 22.4 km² nga e cila 6.3 km² janë sipërfaqe urbane.

Ai pozicionohet:

- 125 km larg kryeqytetit të Shqipërisë dhe aeroportit “Nënë Tereza”
- 92 km nga porti i Durrësit
- 85 km nga porti i Vlorës
- 212 km nga porti i Sarandës
- 250 km nga pikat kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës.

Ndarja administrative e Bashkisë Berat

Njësitë administrative përbërëse	Sipërfaqja (km ²)	Fshatrat/Qytetet në përbërje të NJA
Berat	19 km ²	Qyteti Berat
Otlak	52.7 km ²	Lapardha1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dushnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e sipërme, Orizaj, Otlak
Velabisht	93.2 km ²	Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Vetterrik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnjë, Duhanas, Kodras, Velabisht
Sinjë	138.5 km ²	Kamçisht, Levan, Velçan, Osmenezet 1, Osmenezet 2, Plashnik i Vogël, Molisht, Sinjë
Roshnik	78.7 km ²	Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Vojnik, Rabjak, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël

Berati është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe Kalasë, Muzeu Kombëtar i Ikonografisë “Onufri” dhe galeritë e tjera, muze, kishat, xhamitë).

Historia mbi 2400 vjeçare e bën atë ndër qytetet më të vjetër të vendit tonë. “Qytet Muze” nga viti 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorrit (2,416m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218 m).

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia, turizmi, agro përpunimi dhe sektori i shërbimeve.

Njësitë Otlak, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë kanë si sektor bazë bujqësinë. Kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë është parësor në këto zona.

Në Berat prodhimi i ullirit është në nivele të larta dhe është një nga produktet bujqësore të rëndësishme, ku sipërfaqja e mbjellë me ullinj është 31.9 km².

Berati është zhvilluar si qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionit gjeografik, traditës historike, resurseve që mbart në këtë fushë dhe aksesit me rrugët kombëtare.

E rëndësishme të citojmë si tregues mesatar se Qyteti i Beratit ka si sektor kryesor ekonomik shërbimet, 66.9% është raporti i numrit të punësuarve në këtë sektor ndaj numrit të punësuarve gjithsej. Duke u pasuar nga industria me 29% dhe në fund bujqësia me 4.1 %.

Njësitë Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik kanë si sektor kryesor të ekonomisë bujqësinë. Në njësinë Sinjë dhe Roshnik punësimi në bujqësi me rreth vlerën 90%.

Njohur si në potencial jo më pak ndikim në të ardhurat vendore Bashkia është përfshirë në një punë të plotë projektuese për tregjet me qëllim që të stabilizohen dhe të krijohen kushtet për

zhvillim normal të aktivitetit të tyre sidomos për sa iu përket tregjeve sezonale të produkteve bujqësore.

Treguesit demografikë kanë rëndësinë e tyre , të cilët kanë treguar stabilitet në këtë drejtim duke ruajtur një numër popullsie rreth 100 mijë banorë.

(Burimi i Informacionit: Plani i Përgjithshëm Vendor / Plani i Zhvillimit Strategjik PPV/PZHS)

Vizioni strategjik, që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Beratit gjatë 15 viteve të ardhshme” *"Berati është një qytet i trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar, urbane dhe rurale, me cilësi të lartë jetese, i lidhur mirë me zonat qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukturë moderne, si një destination i fuqishëm turistik dhe portë hyrese/pritëse për një rajon të pasur natyror.*

Një nga asetet me me vlerë të Bashkisë Berat janë qytetarët e saj, ndaj rëndësi e veçantë i jepet nxitjes së kualifikimit të kapitalit njerëzor, për të rritur integrimin e të gjithë qytetarëve aktivenë tregun e punës.

Qëllimi kryesor: *harmonizimi i zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë përmes parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.*

Misioni i bashkisë në funksion të këtij vizioni zhvillimi është:

Vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave publike dhe private, për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Berat.

2.2 INFORMACION PËRMBLEDHËS PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PBA 2026 - 2028

Hartimi i projektit buxhetor 2026 dhe afatmesëm 2026-2028 është bërë bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “ Për procedurat standarte të pëgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të qeverisjes vendore” ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, ligjit 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 65, pika 1, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, ligjit 93/2024 “Për një ndryshim në ligjin nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë minimale”, Vendimin nr. 422, datë 26.06.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 93, datë 28.12.2021, “Për miratimin

e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Berat”, i ndryshuar, Vendimit nr. 540, datë 21.12.1992, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko – Kulturor”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”, Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e PBA Vendor 2026-2028”, të Kalendarit Buxhetor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Berat, si edhe shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 15876 datë 06.11.2025 “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026”.

Në zbatim të tyre u ngrit Grupi për Menaxhimin Strategjik me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë si dhe Ekipeve të Programit, u përgatit Udhëzimi për përgatitjen e PBA 2025-2027 dhe u vu në dispozicion të Grupit për Menaxhimin Strategjik dhe Ekipeve të Programit.

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 36, si dhe të Kalendarit Buxhetor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, Bashkia Berat përgatiti fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, i cili u miratua në Këshillin Bashkiak.

Bashkia Berat ka depozituar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë projekt-dokumentin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm, brenda afateve ligjore.

Gjithashtu, pas miratimit të tavanëve buxhetore përfundimtare të pba 2026-2028 në muajin korrik 2025, u hartua Projekt Dokumenti i Rishikuar (Faza e II-të) i PBA 2026-2028. Dokumenti u dërgua për miratim në Këshillin Bashkiak në muajin shtator 2025.

Thëksojmë se në hartimin e plan buxhetit, sikurse dhe ligjërisht është e përcaktuar, administrata e bashkisë dhe këshilltarët e këshillit bashkiak, udhëhoqën procesin e konsultimit të projektit me publikun, duke organizuar dëgjësata publike, dhe u bënë pjesë e këtij procesi. U zhvilluan 8 dëgjësata publike gjatë muajit Shtator 2025.

Plani i veprimit, proces verbalët e dëgjësata publike si dhe lista e pjesëmarrësve janë pjesë e dokumenteve të hartimit të PBA dhe administrohen nga sekretaria e këshillit bashkiak.

Propozimet e tërhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u administrojnë nga GMS dhe sipas problematikave iu adresuan ndërmarrjeve të vartësive të bashkisë, si dhe sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Berat-Kuçovë, për t’i integruar në programet përkatëse buxhetore, sipas listimit të prioriteteve brenda mundësive financiare.

Problematikat e trajtuara në dëgjësata publike, kërkesat dhe propozimet e bëra nga qytetarët u shqyrtuan nga grupi i hartimit të buxhetit. Një pjesë e tyre janë pasqyruar në këtë projekt buxhet, në fushat e shërbimeve publike, arsimit dhe bujqësisë.

Dokumentet mbi të cilët është mbështetur hartimi i Programi Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe buxheti vjetor 2026 janë :

- Programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë për periudhën 2026-2028.
- Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë.
- Strategjia dhe Plani i Veprimit i Turizmit.
- Strategjitë sektoriale që janë të lidhura me kompetencat e pushtetit vendor.

BUXHETI I BASHKISË BERAT I VITIT 2026 DHE BUXHETI AFATMESEM 2026-2028

Buxheti total i Bashkisë Berat për vitin 2026 është programuar 1,662,819,592 lekë, për vitin 2027 është programuar 1,710,807,213 lekë, dhe për vitin 2028 është programuar 1,744,202,668 lekë .

Financimi i buxhetit realizohet nga :

- **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen.
- **Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme, transfertat e pakushtëzuar sektoriale për funksionet që i janë transferuar Bashkisë në vitin 2016, transfertat specifike dhe transfertat e kushtëzuar.
- **Nga grantet e projekteve të huaja dhe donacionet**, ku përfshihen grantet e përfituara përmes thirrjeve për propozime, për zbatimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar etj, në përputhje me ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve të financimit dhe VKM-ve për miratim në parim të marrëveshjeve të financimit.

Burimet financimit të buxhetit të Bashkisë Berat vitet 2026 – 2028

në lekë

Burimet e Financimit		2026	Pesha	2027	Pesha	2028	Pesha
		Plani	%	Plani	%	Plani	%
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	646,483,000	38.9%	651,975,000	38.1%	656,747,000	37.7%
A.1	Të Ardhura nga Taksat dhe Tarifat Vendore	582,809,000	35.0%	586,391,000	34.3%	589,195,000	33.8%
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	63,674,000	3.8%	65,584,000	3.8%	67,552,000	3.9%
B	Transferta nga Buxheti Qendror	1,012,830,674	60.9%	1,051,942,559	61.5%	1,086,804,887	62.3%
B.1	Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme (përfshirë transf. për rritjen e pagave)	611,514,899	36.8%	650,626,784	38.0%	685,489,112	39.3%
B.2	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	401,315,775	24.1%	401,315,775	23.5%	401,315,775	23.0%
C	Grante të Huaja	3,505,918	0.2%	6,889,654	0.4%	650,781	0.0%
C.1	Grante të Huaja	3,505,918	0.2%	6,889,654	0.4%	650,781	0.0%
Total të ardhura/burime buxhetore (A+B+C)		1,662,819,592	100%	1,710,807,213	100%	1,744,202,668	100%

Burimet e financimit për vitin 2026 paraqiten me një strukturë të stabilizuar midis të ardhurave vendore dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, duke reflektuar një model të qartë fiskal ku pushteti vendor mbështetet kryesisht në transfertat e pakushtëzuara dhe më pak në të ardhura burimore.

Burimet e financimit për vitin 2026 karakterizohen nga një strukturë ku 38.9% mbulohet nga të ardhurat vendore, ndërsa 60.9% nga transfertat qendrore. Pesha e të ardhurave vendore mbetet konstante, çka tregon bazë të stabilizuar fiskale, por edhe kufizime për rritje pa instrumente të reja. Transfertat qendrore përbëjnë burimin kryesor të financimit, të nxitur kryesisht nga rritja e

pagave dhe mbështetja sektorale. Grantet e huaja mbeten minimale (0.2%), duke reflektuar hapësirë të madhe për forcimin e kapaciteteve për projekte të financuara nga donatorët.

Të Ardhura nga Burimet e Veta (A)

646.48 milion lekë – 38.9% e totalit

- Burimet e veta ruajnë peshë solide gati 39%, duke treguar që Bashkia ka bazë të qëndrueshme të ardhurash vendore.
- Rritja ndaj 2027 dhe 2028 është modeste, çka tregon tavan fiskal relativisht të arritur dhe hapësirë të kufizuar për rritje të mëtejshme pa politika të reja vendore.

Nënzërat

A.1 – Taksat & tarifat vendore (582.8 mln lekë – 35.0%)

- Zëri kryesor i financimit vendor, me peshë të qëndrueshme përgjatë 2026–2028.
- Tregon se baza tatimore është e konsoliduar dhe nuk ka parashikim për ndryshime të mëdha në politikën fiskale vendore.

A.2 – Taksat e ndara (63.67 mln lekë – 3.8%)

- Fluktuacion minimal në vite.
- Rritja e lehtë në 2027–2028 lidhet me ecurinë e përgjithshme të ekonomisë kombëtare, jo me vendimmarrje vendore.

2. Transferta nga Buxheti Qendror (B)

1.012 miliard lekë – 60.9% e totalit

- Pjesa dërrmuese e financimit (rreth **61%**) vjen nga buxheti qendror, duke e përforcuar varësinë strukturore të bashkisë nga transfertat qendrore.
- Rritja progresive deri në 2028 lidhet me politikat kombëtare, veçanërisht me rritjen e pagave dhe mbështetjen sektorale.

Nënzërat

B.1 – Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme (611.5 mln lekë – 36.8%)

- Përbën zërin më të rëndësishëm individual të financimit.
- Rritja e këtij zëri deri në 2028 (nga 36.8% në 39.3%) lidhet me **politikat e rritjes së pagave** dhe me prerogativa të reja të pushtetit vendor.

B.2 – Transferta e pakushtëzuar sektorale (401.3 mln lekë – 24.1%)

- Mbështetje e dedikuar për funksionet sektorale (arsim, mirëmbajtje, shërbime).
- Pësia bie lehtë nga viti në vit (nga 24.1% në 23.0%)

3. Grantet e Huaja (C)

3.5 milion lekë – 0.2% e totalit

- Roli i granteve mbetet **shumë i kufizuar** në strukturën e financimit.
- Ndryshimet në 2027 dhe rënia në 2028 tregojnë natyrën e projekteve të përkohshme dhe varësinë nga ciklet e financimit të donatorëve.
- Vlera të tilla të ulëta sugjerojnë nevojën për:
 - më shumë aplikime në programe IPA, donatorë bilateralë, BE, projekte të qëndrueshme urbane, etj.

4. TOTALI 2026: 1.662 miliard lekë

- Struktura e financimit tregon një model të balancuar por të varur nga qendra (61%).
- Ecuria e të ardhurave vendore është e qëndrueshme, pa skenar rritjeje agresive.
- Tendenca e viteve 2026–2028 e zhvendos peshën drejt transfertave të pagave, duke ulur relativisht hapësirën fiskale të bashkisë për politika të reja vendore.
- Grante të huaja mbeten simbolike dhe duhet adresuar si mundësi e pashfrytëzuar.

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E BUXHETIT PËR PERIUDHËN AFATMESME 2026-2028

në lekë

Burimet e Financimit		2026	Pesha	2027	Pesha	2028	Pesha
		Plani	%	Plani	%	Plani	%
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	646,483,000	38.9%	651,975,000	38.1%	656,747,000	37.7%
A.1	Të Ardhura nga Taksat dhe Tarifat Vendore	582,809,000	35.0%	586,391,000	34.3%	589,195,000	33.8%
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	63,674,000	3.8%	65,584,000	3.8%	67,552,000	3.9%
B	Transferta nga Buxheti Qendror	1,012,830,674	60.9%	1,051,942,559	61.5%	1,086,804,887	62.3%
B.1	Transferta e Pakushtëzuar e Pergjithshme (perfshire transf.per rritjen e pagave)	611,514,899	36.8%	650,626,784	38.0%	685,489,112	39.3%
B.2	Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale	401,315,775	24.1%	401,315,775	23.5%	401,315,775	23.0%
C	Grante te Huaja	3,505,918	0.2%	6,889,654	0.4%	650,781	0.0%
C.1	Grante te Huaja	3,505,918	0.2%	6,889,654	0.4%	650,781	0.0%
Total te ardhura/burime buxhetore (A+B+C)		1,662,819,592	100%	1,710,807,213	100%	1,744,202,668	100%
Kategoria e Shpenzimeve		2026	Pesha	2027	Pesha	2028	Pesha
		Plani	%	Plani	%	Plani	%
1	Shpenzime Personeli (600-601)	956,572,000	57.5%	966,136,000	56.5%	975,800,000	55.9%
2	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	506,971,191	30.5%	530,715,191	31.0%	543,108,441	31.1%

3	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	195,770,483	11.8%	207,066,368	12.1%	224,643,446	12.9%
4	Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
5	Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	3,505,918	0.2%	6,889,654	0.4%	650,781	0.0%
6	Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Totali i Shpenzimeve		1,662,819,592	100%	1,710,807,213	100%	1,744,202,668	100%

Disa tregues të rëndësishëm për buxhetin:

Buxheti i vitit 2026 është programuar të jetë 1,662,819,592 lekë, buxheti i vitit 2027 është programuar 1,710,807,213 lekë dhe buxheti i vitit 2028 është programuar 1,744,202,668 lekë.

Buxheti 2026 shënon një rritje të konsiderueshme prej 7.6% ndaj buxhetit fillestar 2025, i nxitur kryesisht nga transfertat qendrore për rritjen e pagave.

Struktura e të ardhurave mbetet e dominuar nga fondet e Buxhetit të Shtetit (60.9%), ndërsa të ardhurat vendore ruajnë peshë të qëndrueshme rreth 39%.

Pesha e shpenzimeve të personelit mbetet e lartë (57.5%), por me tendencë ulëse, ndërsa investimet kapitale rriten nga 11.8% në 12.9%, megjithëse ende nën potencialin zhvillimor. Grantet e huaja mbeten minimale, duke reflektuar nevojë për rritje të kapaciteteve për projekte me financim të jashtëm. Buxheti është i balancuar dhe i përputhur me disiplinën fiskale.

1. Rritja e totalit të buxhetit (krahasuar me fillestarin 2025)

Totali 2025 (fillestar): 1,545,268,802 lekë

Totali 2026: 1,662,819,592 lekë

- **Rritja nominale 2026 ndaj 2025: +117,550,790 lekë**
- **Rritja %: +7.6%**

Kjo rritje është **mbi inflacionin mesatar**, çka tregon zgjerim real të buxhetit vendor, të mbështetur kryesisht nga transfertat qendrore duke përfshirë transfertën për rritjen e pagave.

Tendenca e viteve në vijim

- 2027: 1,710,807,213 lekë → rritje 2.9% ndaj 2026
- 2028: 1,744,202,668 lekë → rritje 2.0% ndaj 2027

Rritja më e fortë ndodh në 2026 (efekti i indeksimeve dhe pagave), ndërsa 2027–2028 karakterizohen nga rritje konservative, e përputhur me politikat fiskale qendrore të stabilizimit.

2. Struktura e financimit – Varësia nga buxheti qendror

Të ardhura vendore 2026: 38.9%

Transferta qendrore 2026: 60.9%

Bashkia mbetet strukturalisht e varur nga buxheti qendror, me mbi 60% të financimit që vjen nga transferta.

3. Të ardhurat vendore

A.1 Taksa & tarifa vendore

2026: 582.8 mln → 2028: 589.2 mln

Rritje totale: +1.1% në 2 vite

Baza vendore është e stabilizuar. Kjo tregon: maturi fiskale (nuk po rriten barrat për qytetarët)

A.2 Taksa të ndara

Rritja 3.8% → 3.9% peshë nuk ndryshon ndjeshëm.

4. Shpenzimet e Personelit

Shpenzimet e personelit 2026: 956.6 mln lekë (57.5%)

2027: 56.5%

2028: 55.9%

- Pagat janë zëri më i madh i shpenzimeve, mbi 55% çdo vit.
- Zinxhiri tregon një ulje graduale të peshës falë stabilizimit të kostove të personelit,
- Kjo kufizon hapësirën për investime kapitale dhe shpenzime zhvillimore.

Në raport me buxhetet vendore në Shqipëri, Bashkia Berat ka nivel të ngjashëm me bashkitë e tjera. Një nivel mbi 55% mund të konsiderohet i lartë, por i qëndrueshëm nëse shërbimet publike janë të standardizuara (arsim, pastrim, administratë).

5. Investimet kapitale

Shpenzimet kapitale 2026: 195.7 mln (11.8%)

2027: 12.1%

2028: 12.9%

- Ka një trend pozitiv, duke u rritur gradualisht si peshë në total.
- Rritja e peshës së kapitaleve 2026–2028 është shenjë e mirë për balancimin midis shpenzimeve korrente dhe atyre zhvillimore.
- Megjithatë, edhe në 2028 investimet nuk kalojnë 13%, që është afër nivelit optimal 15–20% për bashki me potencial zhvillimi urban.

6. Shpenzimet korrente të tjera

2026: 30.5% → 2028: 31.1%

- Pesha e tyre është relativisht e qëndrueshme.
- Rritja e lehtë tregon indeksim të kontratave të shërbimeve (pastrim, mirëmbajtje, energji).
- Nuk ka shenja fryrjeje të shpenzimeve operative.

7. Grantet e huaja

2026: 0.2%

2027: 0.4%

2028: 0.0%

Bashkia Berat synon të përmirësojë në rritje financimin npr granteve të huaja duke kryer Aplikime për programe dhe projektet urbane të BE-së, fondet e gjelbërta, efikasitet energjie, kulturë dhe turizëm.

8. Balanca e buxhetit (të ardhurat = shpenzimet)

Të ardhurat dhe shpenzimet janë **në ekuilibër të plotë** (1:1) për çdo vit, çka tregon:

- planifikim brenda kufijve fiskalë
- mungesë e deficitit

9. Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore :

- ✓ Për programin Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse shkon 11.8 % e buxhetit vjetor, ose shuma 196,273,000 lekë
- ✓ Për programin Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile shkon 31.32 % e buxhetit vjetor, ose shuma 520,844,483 lekë
- ✓ Për programin Arsimi & Kujdesi Social shkon 36.85 % e buxhetit vjetor, ose shuma 612,816,000 lekë

- ✓ Për programin Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore shkon 4.22 % e buxhetit vjetor, ose shuma 70,163,328
- ✓ Për programin Siguria dhe Mbrojtja e Territorit shkon 6.66 % e buxhetit vjetor, ose shuma 110,801,000 lekë
- ✓ Për programin Turizmi, Kultura dhe Sportet shkon 8.29 % e buxhetit vjetor, ose shuma 137,921,781 lekë
- ✓ Për programin Rezerva & Kontigjenca shkon 0.84 % e buxhetit vjetor, ose shuma 14,000,000 lekë

3. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË BERAT NË VITET 2026-2028

3.1 PLANI I TË ARDHURAVE NË BASHKINË BERAT PËR VITIN 2026 DHE PBA 2026-2028

3.1.1 Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028

Mbështetur në metodologjinë bazë të procesit të planifikimit buxhetor dhe në plotësim të referencave ligjore e udhëzimeve në fuqi për këtë proces, Plan buxheti 2026 dhe PBA 2026-2028 vjen si përfundim i përmbylljes së këtij procesi gjatë vitit 2025.

Përmbushja e plotë e kalendarit buxhetor dhe kryerja e të gjitha fazave në kohë cilësisht dhe profesionalisht në më të mirën e mundshme të kapaciteteve tona planifikuese, në këtë pjesë të materialit është e rëndësishme të theksojmë:

Plan buxheti është mbështetur në analizat operative sipas kalendarit, në konkluzionet e degjesave publike si dhe në rekomandimet e dhëna nga degjesat e fundit mbi draftin organizuar nga Këshilli Bashkiak me mbështetjen e stukturave të administratës.

Ai reflekton krahasimisht me draftin, gjithë sugjerimet e marra nga grupet e interesit dhe biznesi në veçanti por më e rëndësishmja bën pjesë të tij ndryshimet që vijnë nga ligji 29/2023 mbi të ardhurat, si dhe paketa fiskale aktuale e miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Materiali është ndërtuar analitikisht për të gjitha burimet shoqëruar me tregues përmbledhës statistikor që janë bazë e rëndësishme e këtij procesi.

Shtojmë gjithashtu se ruan në vijimësi nga viti 2020 strukturën e një buxheti të balancuar dhe merr në konsideratë gjithë ambicjen tonë si një Bashki e sfidave të mëdha, materializuar kjo dhe me investimet e bëra, ato në proces dhe ato ç'ka projektojmë të bëjmë në vijimësi.

Konsolidimit financiar i shërben dhe kjo pjesë organike dhe shumë e rëndësishme e buxhetit që trajtuar në një kapitull të plotë i trajton të ardhurat si një sfidë reale në përmbushjen e vizionit tonë- Buxhet për një zvillim të Qendrueshëm.

Sfida jonë për vitin financiar që po planifikojmë është shfrytëzimi i gjithë mundësive dhe kapaciteteve tona profesionale dhe administrative në përgjigje të:

Rritjes së të ardhurave për më shumë shërbime të shtuara publike.

Krijimin e kapacitetit financiar për të siguruar investimet me donatorë dhe direkt nga të ardhurat tona.

Ruajtjen e trendit të raportit të ardhurave vendore ndaj totalit të të ardhurave gjithësej.

Mbulimit të kostove të shërbimeve me tarifat, një detyrim që ka qënë dhe ngelet një sfidë jo vetëm e këtij viti por dhe në vijim.

Rritje të ndërgjegjësimit të kontribuesve familjare dhe biznesit për të mos krijuar deficite shtesë dhe krijimin e mundësive për të ulur debinë e akumuluar që nga periudha para reformës administrative e në vijim.

Në bashkëpunim edhe me drejtoritë rajonale luftë pa kompromis ndaj evazionit fiskal dhe trajtimin e barabartë perballë ligjit për këdo.

Përditësimin e çdo ndryshimi ligjor që ka efekt financiar mbi të ardhurat dhe njëkohësisht gjetjen e burimeve shtesë për të rritur të ardhurat vendore.

Monitorim në vijimësi, përgjegjshmëri maksimale ndaj objektivave dhe gjetjen e mundësive dhe resurseve për të ardhura shtes, pa kosto sociale por me një barazi të plotë ligjore për të gjithë tatimpaguesit.

Me moton Biznesi Partner dhe me ofrimit në kohë me cilësi e korrektesë të shërbimit ndaj tyre, ne gjithë kontribuesit i quajmë partner dhe jo thjeshtë taksapagues. Për këtë realizojmë degjesat, njohim kërkesat dhe ndjekim në vijimësi ecurinë e tyre.

Nëse iu referohemi statistikave nga ana e nivelit të realizimit të të ardhurave në vite, dukshëm kemi një qendrueshmëri të nivelit të realizimit të detyrave të planifikuara nga biznesi. Trendi në rritje i këtij indeksi shërben për ne si një moto për të gjetur hapësira e mundësi edhe për kontributorët e tjerë dhe jo vetëm.

Procesi i planifikimit realizohet nga qeliza bazë dhe del në përfundim të një analize të plotë faktoriale si një agregat që krijon mundësi reale për monitorimin e tij.

Askush nuk e sheh veten jashtë këtij procesi dhe tek secili ndihet përgjegjshmëria për gjatë gjithë vitit financiar. Kjo një mundësi më shumë për të shmangur planifikimin jo real dhe ndërtimin e një materiali thjeshtë procedural. Gjithkush që është i përfshirë në strukturën e administratës ku gjenerojnë të ardhura ka përgjegjësinë dhe përgjegjësinë e plotë për të bërë të mundur realizimin e objektivave të planifikuara.

Është për këtë arsye pse ne themi se referuar hapave të ndjekura konkludojmë se kur krahasojmë dinamikën e të ardhurave me objektivat e vendosura ne njohim:

- Nivelin e treguesve të arritur jo vetëm në vitin aktual.
- Ndryshimet ligjore në se ka të tilla dhe implementimin e çdo ndryshimi ligjor në vijimësi.
- Analizojmë dhe nxjerrim konkluzionet e duhura për çdo faktor ndikues në secilin tregues dhe në zërat analitik.
- Konstatojmë problematikat dhe shkojmë tek zgjidhja e tyre pavarësisht në se vlera dhe ndikimi është i ndjeshëm apo jo. Thënë ndryshe njohim në detaj dhe zgjidhim fenomenin që rrjedhimisht do na çojë tek arritja e realizimit të çdo treguesi.
- Për ne në ato zëra që mbulohen kosto tarife ne planifikojmë mbështetur mbi kapacitetin dhe monitorojmë shfrytëzimin e kapacitetit që rrjedhimisht na çon në ndryshimet e njëkohshme si në shpenzime dhe në të ardhura. (citojmë këtu të ardhurat në arsim apo në ASHP për sektorin e Varrimit. Shërbime këto që ofrojnë të ardhura deri në koston e tyre).

- Ndikimin në investime në zhvillimin ekonomik dhe për rrjedhojë në rritjen e të ardhurave. (pritsmëritë i masim jo me atë ç'ka ka pasur si qëllim projekti por me efektin që ai jep në realitet si në jetën sociale ashtu dhe në të ardhura) Thënë këtë kur planifikojmë objektivat i përcaktojmë në kufijtë e tyre maksimal të pritshëm.

Paketa fiskale dhe ndryshimet ligjore të përfshira janë baza kryesore e planifikimit dhe përcaktimit të objektivave. Ashtu sikurse edhe për gjatë vitit financiar 2025 çdo ndryshim i vendimuar nga Këshilli bëhet pjesë dhe e ndryshimit të planit të të ardhurave.

Ne e kemi tashmë përvojën dhe kualitetin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për këtë proces.

Ajo që ne bëjmë është rritja e nivelit profesional të stafit me të reja e këtij procesi dhe bëjmë pjesë të punës në përditshmëri çdo përditësim të ri.

Njohim, analizojmë dhe konkludojmë pritsmëritë në një periodicitet të vijueshëm dhe kjo krijon mundësinë për të rritur pritsmëritë apo edhe për të bërë të mundur ndryshimet në kohë, në mënyrë që dhe projeksionet e shpenzimeve të mos i prishim balancën e vetë.

Si një pjesë e rëndësishme e së tërës dhe me një efekt në totalin e financave të bashkisë kërkojmë gjithmonë kapacitet cilësi e profesionalizëm.

Edhe ky plan është ambicioz në përgjigje të motos që ka bashkia, si Bashki e sfidave të mëdha dhe si i tillë ka në strukturën e vetë risi dhe sfida të vetë uljen e debisë së akumuluar në vite nga periudha para reformës administrative dhe në vijimësi. Ne punojmë me strukturë të vecantë për mbledhjen e borxhit bazuar në një rregullore të brendshme të miratuar. Është kjo strukturë që koordinon në vijimësi me agjentët tanë tatimor si Drejtoria Rajonale Tatimore dhe Shoqëria e Ujësjetës apo dhe të tjerë.

Sikurse do të lexohet në realizimet mjafton të citojmë zërin e të ardhurave personale. Frut i këtij rakordimi dhe monitorimi në vijimësi për gjatë gjithë vitit është realizimi i këtij zëri. Dhe kjo si rezultat i marrjes së këtyre të ardhurave në mënyrë periodike nga Drejtoria Rajonale mbi bazën e një grafiku të përmirësuar gjatë vitit financiar në përputhje kohore të plotë me ndryshimet ligjore.

Pse njohim vështirësitë e biznesit dhe nga ana tjetër edhe rritjen e bizneseve në disa fusha siç është ajo e turizmit, sërish në të gjitha projeksionet tona konstatojmë se;

Biznesi në Bashkinë e Beratit po konsolidon vetëveten dhe përballet me sfidat e rritjes.

Ai nuk ndryshon në numrin total por në strukturë. Eksporti kryesisht ai fason përballet me efektet e kursit të këmbit dhe kërkon përshtatje me tregun aktual dhe tregjet e reja në shtete të tjera.

Mungesa e fuqisë punëore të kualifikuar është një tjetër sfida sikurse dhe të tjera vështirësi sjellin si rrjedhim ruajtjen dhe kërkesën për mundësi të reja.

Pa rënë në përsëritje por për nga rëndësia vlen të theksojmë se në tërësinë e vet plani i të ardhurave kërkon rritje të përgjegjësisë performuese të punjosve dhe kualitet profesional për implementimin e tij.

Referuar pritsmërive në disa zëra ka një mos realizim të ndjeshëm por ne ndalemi këtu kur planifikojmë për vitin 2026 sepse njohim shkaqet që kanë ndikuar:

Ndërtimi është përballë një oferte që ndikohet nga kursi i këmbimit dhe çështjet e pronësisë ende të pa zgjidhura.

Edhe pse kanë nisur procesin e marrjes së lejes ende nuk e kanë marrë atë për të mos marrë rrishtun e çmimit për njësi në treg kur dihet që ato kanë për bazë monedhën euro.

Nga analiza rezulton se rënia e euros, ka rritu çmimin për njësi në ndërtimet e reja dhe këto çmime janë të luhatshme aktualisht dhe jo me indekse ndikimi të vogla.

Ndryshimi nga 550 euro në 800 euro i bën ndërtuesit në momentin fillestar të gjejnë çmimin e qëndrueshëm për të dalë në treg dhe të presin një ulje të disnivelit të fashës max-min çmimi. Është për këto arsye pse niveli i realizimit të planit të ardhurave nga ndërtimet e reja është ndjeshëm më ulët se plani dhe përtej pritshmërive. Ky fakt pa u injoruar gjykojmë në përfundimin se plani për këtë zë - ndërtime të reja duhet të jetë në nivelin e planit 2025.

Pritshëria për ndryshimet në çmimet e referencave që pritet të ndodhin në 2026, nisja e punimeve për aplikimet e përfunduara por ende të pa tërhequra nga investitorët na motivojnë që në planin e të ardhurave nga ndërtimet e reja të mos ndryshojmë objektiv.

Ashtu sikurse edhe ndryshimi i çmimeve në tregun e qerave nga ndryshimet e ligjit për të ardhurat 29/2023, na çon në përfundimin se nga të ardhurat e pronësisë do të ketë një rritje të të ardhurave. Ne konkludojmë se ju sjellim për miratim një plan të ardhurash ndjeshëm më të lartë se niveli i pritshmërisë së realizimit të vitit 2025 dhe për këtë marrim në konsideratë një sërë faktorësh.

Në fushën e urbanistikës pritshmëritë për investime janë ndjeshëm të larta për vitin në vijim, dhe normalisht projektojmë të njetin nivel sa plani 2025 por shumë herë më të lartë se realizimi i pritshëm në fund të vitit financiar.

Në fushën e arsimit, planifikimin e mbështesim mbi kapacitetin infrastrukturor dhe investimet e bëra për përmirësimin e kushteve në to gjatë këtij viti financiar.

Në bujqësi të ardhurat i planifikojmë në vlerë absolute sikurse i kemi projektuar në PBA 2026-2028 (draft) kjo pasi aty kanë nisur një sërë reformash sidomos në drejtim të sipërfaqes së tokave. Në ujë ne kemi investuar në mirëmbajtjen e kanaleve vaditës dhe nga riorganizimet e bëra ne presim një arkëtim më të ndjeshëm.

Gjithashtu nga lejet e dhëna për familjet për dru zjarri në zbatim të VKB procesi është në përmirësim dhe pritshmëritë janë të larta dhe në këtë drejtim.

Sa me sipër ne gjykojmë që për vitin që planifikojmë kemi mundësi objektive për të përmbushur objektivat e vendosur.

Dhe jo vetëm.

- Shumë investime janë drejt përfundimit, te tjera investime do të nisin dhe investime të reja po projektojmë. Efekti i tyre natyreshëm do të sjellë frymëmarrje.
- Turizmi dhe pritshmëritë sidomos në implementim të përmirësimit të vetë deklarimit për taksën e fjetjes do të japin ndikim në plotësim të objektivit.
- Konsolidim i qëndrueshmërisë së biznesit sipas llojit dhe qëndrueshmëria e numrit të biznesit një argument tjetër që na çon në përfundimin e një plani të mirë hartuar në përshatje me realitetin ekonomik.

2- Struktura e biznesit sipas llojit.


Nëpërmjet pasqyrës se me poshtme krijohet panorama e plote e strukturës së biznesit dhe krahasimi me planin 2025.

Njësi tregtare biznes biznes i vogël:

TOTALI	P/ 2025	BERAT	OTLLAK	VELABISHT	ROSHNIK	SINJE	P/ 2026	#NR 2025-2026
	1762	1367	233	131	25	18	1774	12
Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	80	58	17	2	3	7	87	7
Prodhim	109	73	15	17	2	3	110	1
Shitje me pakicë	603	468	97	55	8	3	631	28

Bar - Kafe	231	187	28	15	2	0	232	1
Ushqimore	96	66	10	9	-	-	85	-11
Profesione të lira	138	128	4	2	-	-	134	-4
Shërbime	371	301	53	20	1	2	377	6
Transport	115	70	9	10	9	3	101	-14
AMBULANT	19	16	-	1	0	-	17	-2

Grafikisht të dhënat e mësipërme do të shpreheshin:




E rëndësishme të theksojmë se biznesi dhe administrimi të ardhurave behet nga drejtoria pavarësisht vendodhjes së tij. Kjo shoqëruar me paketën fiskale është një argument për të gjykuar për nivelin e treguesve që planifikojmë.

Të dhënat janë si më poshtë krahasimisht sipas llojit dhe krahasimisht me planin 2025:

TOTALI	BERAT	OTLLAK	VELABISHT	ROSHNIK	SINJE	P/2025	P/2026	# NR 2023-2024
Subjekte të Biznesit Madh	458	69	14	2	13	552	556	4
Transport	64	0	0	0	0	57	64	7
Import eksport	277	59	8	2	7	343	353	10
Prodhim	52	5	4	-	6	75	67	-8
Ndertim	27	5	2	-	0	35	34	-1
OJF	20	-	-	-	-	20	20	0
Banka	18	-	-	-	-	22	18	-4

Sipas llojit të dhënat grafiksht do të shpreheshin :



Referuar të dhënave të mësipërme lehtësishtë vijmë ne përfundimet e më poshtme :

- Dallueshëm biznesi ka një qëndrueshmëri sipas llojit dhe në vlerë ndryshimi në vlerë absolute është +16 subjekte
- Eksport import ka një shtese të numrit të bizneseve dhe merr mbi 50 % të ndryshimit sasior.

Pra biznesi në natyrë, ka një rritje shumë të vogël në numër, dhe sipas llojeve nuk ka shtim Kjo rrjedhimisht të çon në përfundimit se Biznesi beratas është i përqendruar në Qendrueshmërinë e tij sipas llojit në reference të plotë me tregun e vet.

Kjo është shprehje e qëndrueshmërisë ekonomike të Bashkisë, Berat dhe në një trend të qëndrueshëm të biznesit.

Pyetjes se çfarë ndryshimi te pritshëm konstaton grupi i punës ne planin 2026, në projeksionet e veta?

Po, ne duke njohur trendin e investimeve në infrastrukturë urbane, efekte e përfundimit të tyre në komunitet dhe Biznes, ne presim ndryshime me nje probabilitet të lartë. Kryesisht nga rritja e turizmit, tregut të import eksport apo në biznesin e shërbimeve.

Me deduksion llogjik, ne gjykojmë se këto ndryshime të pritshme do të ndodhin në tremujorin e dytë te vitit financiar 2026, dhe normal ato ndryshimet do të reflektohen në ecuri dhe do ti bëhen prezent në kohë këshillit. Ajo që ne nuk e vendosim në plan këto ndryshime të pritshme si objektiv i planifikimit mbështetet nga: afati kur përfundojnë investimet në proces, apo dhe fluksi i turistëve që pritet të jetë. Kjo nuk bëhet për shmangie të sfidave por njohur, riskun dhe analizën e tij, gjykojmë se mos përfshirja është një eliminimi i faktorëve negativ në procesin e planifikimit e si dhe fakti tjetër që për këtë buxhet ne do të vijmë në muajin shkurt për rishikim e tij. Moment ky që indikatorët do të jenë edhe më pranë realitetit e pritshmëritë në kufij maksimal të projeksioneve.

Referuar edhe faktit 2025 (10 mujori dhe i pritshmi vjetor) sidomos në drejtim të të ardhurave qartësish turizmi jep premisa shumë pozitive, sikurse dhe Tatimi mbi te ardhurat Personale.

Mjafton për këtë të ardhurat nga hotelet, ku detyra e planifikuar është rritur, madje mbi kufijte e planifikuar për vitin 2025 si dhe të ardhurat nga të ardhurat personale që janë shumë herë më lartë se detyra e planifikur krahasimit me faktin apo pritshmërit.

Me rendësi është edhe fakti i ndryshimeve për hotelerinë dhe bujtina për mbledhjen e taksës së fjetjes dhe deklarimin e biznesit.

Ende pushteti vendor vuan për informacion nga institucioni i Kadastrës, dhe për rrjedhim ne nuk mund të jemi optimist përtej pritshmërisë për taksën e pronës. Janë në proces shumë pjesë të legjislacionit në fuqi dhe për rrjedhim sa citojmë na bën më optimist si në pritshmëritë vjetore 2025 ashtu dhe gjatë implementimit të këtij plan Buxheti.

Le të analizojmë pak më gjerësisht administrimin dhe grumbullimin e taksave dhe tarifave nga familjet.

Edhe nga analizat periodike, dëgjuesat publike dhe nga administrata e njësive është konstatuar se vijojmë të kemi objektiv e të punojmë në këto drejtime edhe gjatë vitit 2026 :

- Në njësitë administrative të zonës jo urbane, kryjemë në vijimësi një proces përditësimi të të dhënave. Programojmë ti përmirësojmë duke kërkuar angazhim konkret nga kryetarët e fshatrave dhe më tej programojmë të aplikojmë metodat ligjore të bllokimit të llogarive dhe bllokimin e mundësive për të marrë shërbime në njësi pa likujduar detyrimet ndaj bashkisë.
- Do të rrisim bashkëpunimin me institucionet që ofrojnë shërbime në fushën e kadastrës, Drejtorinë e Barrës Siguruese për përdorur masa ndëshkuese për ata që nuk likujdojnë detyrimin ndaj bashkisë.
- Kemi përmirësuar e pastruar regjistrat tane të llogarive dhe tani e njohim realisht masën e detyrimeve të pa arkëtuar, bazë e rëndësishme si në aspektin e implementimit apo dhe atë të monitorimit apo dhe të hartimit të një plan veprimi që i shërben uljes së këtyre detyrimeve që kanë familjet ndaj Bashkisë.

- Provigjonet financiare të Bashkisë Berat

Bashkia njihet detyrimet që biznesi ka ndaj saj. Është në proces gjyqësor me disa prej debitorëve të saj. Njëkohësisht debia e mbartur në vite është e lartë dhe me mundësi të pakta arkëtimi.

Deri në përfundimin e këtyre proceseve, për këto të ardhura të munguara, bashkia nuk planifikon të arkëtohen në shumën e plotë, por i trajton ato si provigjone financiare.

Sipas llojit këto të ardhura të munguara kanë të bëjnë me debi të shpallura nga bashkia apo dhe KLSH.

E rëndësishme është që në vitin financiar 2025 trendi i debisë nuk ka ardhur duke u shtuar por dhe arketimet nga debia e mbartur ka një rënie e cila shprehur në indeks është modeste por dhe premtuese në ecuri..


Njëkohësisht, sipas ligjit ne planifikojmë taksë qera toke për Guroret, të cilat janë gjithësej **6 (gjashtë)** në territorin e bashkisë. Edhe në këtë plan ne kemi planifikuar por jo në shumë totale të llogaritur, pasi Bizneset kanë hapur proces gjyqësor, dhe ecuria e tyre tregon se priten vendime të formës përfundimtare, të cilat do të burojnë të ardhura aq sa dhe ne planifikojmë. Kjo mbi bazën e një propabiliteti mbi mundësinë e fitimit të këtyre vendimeve gjyqësore.

Qysh në planifikim në vijmë me objektiva të përcaktuar sipas Drejtorive dhe njësive administrative, dhe kemi bërë pjesë të këtij plani njësitë drejtoritë dhe specialistet sipas funksionit pjesë të rëndësishme të tij.

Nr	Emertimi	Plani 2026	Struktura
I	Agjentët Tatimore	63,674	10%
II	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave	360,900	56%
III	Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve	29,050	4%

IV	Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve	85,074	13%
V	Drejtoria Bujqsise, Administrimit te Pyjeve, Ujerave dhe Sherbimit Veterinar	67,404	10%
VI	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	23,350	4%
VII	Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes	30	0%
VIII	Te ardhura nga MZSH	650	0%
IX	Te tjere debitore (gjyqe dhe klsh)	5,900	1%
X	Agjencia e sherbime publike	10,450	2%
TOTALI		646,481	100%

Grafikisht të ardhurat sipas drejtorive:



Parë Bashkinë Berat si një të tërë, në vitin 2025 bizneset aktivë në sistemin tatimor janë si më poshtë:

A – Në Njesitë Administrative Berat për vitin 2025 ushtrojnë aktivitetin ekonomik **1782** biznese, nga të cilat **1,346** janë biznese të vogla të cilat mbështeten kryesisht në shërbime e më pak në prodhim. Klasifikuar në grupe si më poshtë:

Nr	Grupet e taksëpaguesve	Baza e llogaritjes (Nr. /bizneseve)
II	Subjekte të biznesit vogël	1346
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	55
2	Prodhim	73
3	Shitje me pakicë	468
4	Bar - Kafe	178
5	Ushqimore	66
6	Profesione të lira	121
-	Noter, Farmaci, Avokat, Permbarues, Stomatolog, Labrator mjeksor & dentar	71
-	Profesione te lira te tjera	50
9	Shërbime	299
10	Transport	70
11	Ambulant	16

Grafikisht të dhënat e mësipërme janë:




Biznesi i madh:

Karakteristikë është struktura e biznesit të madh i cili në strukturën e tij mbështetet në fushën import eksport dhe në transport. Kjo pasi kjo degë e ekonomisë ka zhvillim dhe në të shumtën e tij mbështetet në shoqëritë fason:

Nr	Grupet e taksapaguesve	Baza e llogaritjes (Nr. bizneseve)
III	Subjekte të biznesit madh	454
1	Transport	19
2	Transport udhetaresh	37
3	Transport Urban	7
4	Import eksport	276
5	Prodhim	50
6	Ndertim	27
7	Banka	18
8	OJF	20


Grafikisht të dhënat e mësipërme janë:



Sikurse shprehet import – eksport dhe shërbimi i transportit kanë numrin më të madh.

Në Bashkinë Berat ushtrojnë aktivitet institucionet si më poshtë:

Institucione Shtetërore	47
Institucionet, Me numër të punësuarish ≤ 5 vetë	10
Institucionet, Me numër të punësuarish 5 deri 20 vetë	14
Institucionet, Me numër të punësuarish ≥ 20 vetë	23



B- Në njësitë administrative bizneset janë si më poshtë :**Otlak**

Nr	Grupet e taksapaguesve	Baza e llogaritjes (Nr.bizneseve)
II	Subjekte të biznesit vogel	230
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	16
2	Prodhim	15
3	Shitje me pakicë	97
4	Bar - Kafe	28
5	Ushqimore	10
6	Profesione të lira avokate noter stomatolog permbarues kabinet mjekesor dhe dentar	2
7	Profesione te lira te tjera	2
8	Shërbime	51
9	Transport	9
III	Subjekte të biznesit madh	70
1	Import eksport	58
2	Prodhim	5
3	Ndertim	5
4	Perpunim Guri	2

C-Në njësitë administrative bizneset janë si më poshtë :**Velabisht**

Nr	Grupet e taksapaguesve	Baza e llogaritjes (Nr. bizneseve)
II	Subjekte të biznesit vogel	127
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	2
2	Prodhim	17
3	Shitje me pakicë	54
4	Bar - Kafe	14
5	Ushqimore	9
6	Profesione të lira avokate noter stomatolog permbarues kabinet mjekesor dhe dentar	1
7	Profesione te lira te tjera	1
8	Shërbime	18
9	Transport	10
10	Ambulant	1
III	Subjekte të biznesit madh	12
1	Transport	-
2	Import eksport	8
3	Prodhim	4

D - Në njësitë administrative bizneset janë si më poshtë :**Sinjë**

Nr	Grupet e taksapaguesve	Baza e llogaritjes (Nr. bizneseve)
II	Subjekte të biznesit vogel	22
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	7
2	Prodhim	3
3	Shitje me pakicë	5
4	Ushqimore	2
5	Shërbime	2
6	Transport	3
III	Subjekte të biznesit madh	16
1	Import eksport	7
2	Prodhim	6
3	Përpunim guri	3

E - Në njësitë administrative bizneset të mëdha dhe të vogla janë si më poshtë :**Roshnik:**


Nr	Grupet e taksapaguesve	Baza e llogaritjes (Nr.bizneseve)
II	Subjekte të biznesit vogel	24
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	2
2	Prodhim	2
3	Shitje me pakicë	8
4	Bar - Kafe	2
5	Shërbime	1
6	Transport	9
III	Subjekte të biznesit madh	4
1	Import eksport	2
2	Perpunim guri	2

Sikurse shihet nga të dhenat e pasqyruara analitikisht për biznesin sipas klasifikimit, dhe vendodhjes së tij administrative, kemi një përqëndrim të tij në Njësinë Administrative Berat, e duke vijuar në Njësin Otllak, e Velabisht.

Sa më sipër në mënyrë te përmbledhur kemi :

Njësia	Totali	Subjekte të biznesit vogël	Subjekte të biznesit madh
Berat	1800	1346	454
Otllak	300	230	70
Velabisht	141	127	14
Roshnik	28	24	4
Sinjë	38	22	16

Grafikisht të dhënat e mësipërme do të paraqiteshin :



Sa lexohet për ligj sa trajtuam më sipër për shpërndarjen gjeografike të biznesit sipas ndarjes administrative dhe qartësisht dallohet se zonat më ekonomike ku biznesi ka më shumë shtrirje kanë renditjen:

- 1- Berat
- 2- Otlak
- 3- Velabisht
- 4- Sinjë
- 5- Roshnik.

Renditje kjo e ndërtuar sipas ndarjes administrative të bashkisë.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2026 mbështetet në :

- Implementimin e Paketës Fiskale të vitit 2025 .

Për vitin 2026 të ardhurat nga taksat dhe tarifat parashikohen në shumën **646,483,000** lekë. Këto të ardhura përbëhen nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, taksa mbi ndërtesën, tabelën etj.

• LEHTËSIRAT TATIMORE

Theksojmë se nuk kemi ndryshime të paketës fiskale por, i risjellim të plota lehtësirat tatimore sipas paketës ekzistuese, pasi janë pjesë e rëndësishme e përlogaritjes së treguesve të planifikuar.

Pjesë kjo që për ligj faktin që edhe plan buxheti i vitit 2026 është buxhet social.

1 . Përrjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- 1.pronat e shtetit dhe të njërive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
2. pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- 3.ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- 4.banesat sociale në pronësi të bashkive;
- 5.pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
6. ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- 7.strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- 8.ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- 9.ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- 10.ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.
- 11.ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë.

2.Përrjashtohen nga pagimi i taksës mbi tokën bujqësore :

- 1.Përrjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
- 2.Taksapaguesit që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, vet-eranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë

3. Përrjashtimet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë :

- a. investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.
- b. investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
- c. investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përrjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përrcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- ç. investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përrballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

4. Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a. Enti Kombëtar i Banesave, ministria përgjegjëse për financat dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore.
- b. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar;
- c. Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - (i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - (ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak apo struktura e deleguar nga ky i fundit për përfshimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agentit të taksave.

Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

5. Përfshihen nga tarifa për infrastrukturën arsimore:

1. Tregtarët ambulantë që tregëtojnë në tregun industrial për Njësine Administrative Berat, përfshihen nga pagesa për tarifën për infrastrukturën arsimore.
2. Subjektet në zonën depressive ekonomike:
 - "Rruga "Rilindja"- shkolla "Thimi Tani" ish fillimi i rrugës Toska në lagjen "Jani Vruho". Rruga "Kondas" - fillimi i rrugës "Toska" shkolla "Kristo Isak".
 - Bizneset e reja për vitin e parë janë të përjashtuara nga tarifa për infrastrukturën arsimore, për vitin e dytë do të paguajnë 50% të tyre dhe në vitet në vazhdim, vlerën e plotë të tarifës
3. Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.
4. Familjet që kanë kryefamiljarë që janë persona me aftësi të kufizuara.
5. Personat që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë.

6. Përfshihen nga Tarifa e Pastrimit e largimit të mbeturinave dhe mirëmbatjes së hapësirave publike, Tarifa e Ndriçimit, Tarifa e Gjelbërimit

1. Tregtarët ambulantë që tregëtojnë në tregun industrial për Njësine Administrative Berat, përfshihen nga pagesa për tarifën.
2. Subjektet në zonën depressive ekonomike:
 - "Rruga "Rilindja"- shkolla "Thimi Tani" ish fillimi i rrugës Toska në lagjen "Jani Vruho". Rruga "Kondas" - fillimi i rrugës "Toska" shkolla "Kristo Isak".
 - Bizneset e reja për vitin e parë janë të përjashtuara nga tarifa gjelbërimit publik, për vitin e dytë do të paguajnë 50% të tyre dhe në vitet në vazhdim, vlerën e plotë të tarifës. Në pasqyrat e mëposhtme paraqitet analitikisht planifikimi i çdo taksë dhe tarifë vendore për vitin 2026.

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E PLANIT TË TË ARDHURAVE TË VITIT 2026 TË BASHKISË BERAT.

Të dhënat ne 000/lekë

Tabela 22

PLANI I TË ARDHURAVE SIPAS DREJTORIVE

Nr	Emertimi	Plani 2026
I	Agjentet Tatimore	63,674
1	Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	18,000
2	Takse e kalimiti te drejtes se pronsise(ZRPP)	3,311
3	Takse e mjeteve te perdorura	42,183
4	Taksa e rentës minerare	180
II	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave	360,900
1	Takse tabele	1,986
	Tabelë për qëllime identifikimi	1,585
	Tabelë për qëllime reklamimi	401
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	15,775
3	Takse fjetje ne hotel	7,216
4	Takse mbi token bujqesore	18,433
5	Takse mbi ndertesat	51,460
	Biznes	24,310
	Familje	27,150
6	Takse trualli	8,087
	Biznes	6,794
	Familje	1,293
7	Tarife e pastrimit	107,434
	Biznes	56,947
	Familje	47,817
	Institucione	2,671
8	Tarife e ndriçimit publik	48,606
	Biznes	18,672
	Familje	29,410
	Institucione	524
9	Tarife gjelberimi publik	41,799
	Biznes	12,603
	Familje	28,628
	Institucione	568
10	Tarife Arsimit publik	11,724
	Biznes	4,477
	Familje	7,012
	Institucione	235
11	Te tjera tarifa(Ambjenti)	1,226
12	Tarife per linjat ajerore nentokesore (Kablloret)	1,964
13	Te ardhura nga parkimi	2,744
14	Debitore Familje	19,886
15	Debitore Biznesi	22,561
III	Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve	29,050
1	Tarife per license /certifikate per transport rrugor	2,340
2	Te ardhura nga qerate	26,710
3	Debitore	-
IV	Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve	85,074

1	Tarife urbanistike	732
2	Taksa e Ndikimit ne infstrukture nga ndertimet e reja	84,342
V	Drejtoria Bujqsise,Administrimit te Pyjeve,Ujerave dhe Sherbimit Veterinar	67,404
1	Tarife per lende drusore	80
2	Tarife ujitje	1,535
3	Te tjera te ardhura nga pronesia	65,789
VI	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	23,350
1	Te ardhura nga konviktet	2,980
2	Te ardhurat per regjistrim	965
3	Te ardhura nga kopshtet dhe cerdhet	19,405
VII	Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes	30
1	Tarfia per zenie salle dhe dheniie ambjentesh me qera	30
VIII	Te ardhura nga MZSH	650
IX	Te tjere debitore (gjyqe dhe klsh)	5,900
X	Agjencia e sherbime publike	10,450
1	Tarifa e sherbimit te varrimit	6,380
II	Te ardhura nga parkingu	3,650
III	Te tjera te ardhura nga biletat "PARKU DUA TE LUAJ"	420
XI	Te ardhura te priteshme nga bashkefinancimet e huaja	-
TOTALI		646,481

Si një risi planifikuese është ndarja korrekte e planit dhe përqëndrimi i tyre sipas burimit dhe njësive administrative, dhe jo vetëm por çdo drejtori që ka në funksionin e vet akses në të ardhurat vendore dhe janë vendimarrëse në proces kanë të detajuar planin e tyre.

Ndryshimi qëndron sidomos për njësitë administrative të cilat u përfshinë gjatë gjithë procesit dhe solli jo pak ndryshime në të dhënat bazë përlllogaritëse.

Faktor ky që rrit përgjegjësinë e punonjësve në njësinë administrative dhe mat performancën e tre në mënyrë korrekte.

PLANI I TË ARDHURAVE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE BERAT DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

Të dhënat në 000/lekë

Nr	Emertimi	Plani 2026
I	Taksat vendore	102,957
1	Takse tabele	1,986
•	Tabelë për qëllime identifikimi	1,585
•	Tabelë për qëllime reklamimi	401
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	15,775
3	Takse fjetje ne hotel	7,216
4	Takse mbi token bujqesore	18,433
5	Takse mbi ndertesat	51,460
•	Biznes	24,310
•	Familje	27,150
6	Takse trualli	8,087
•	Biznes	6,794
•	Familje	1,293
II	Tarifat vendore	211,527
1	Tarife e pastrimit	107,434
•	Biznes	56,947
•	Familje	47,817
•	Institucione	2,671
2	Tarife e ndriçimit publik	48,606

•	Biznes	18,672
•	Familje	29,410
•	Institucione	524
3	Tarife gjelberimi publik	41,799
•	Biznes	12,603
•	Familje	28,628
•	Institucione	568
4	Tarife Arsimit publik	11,724
•	Biznes	4,477
•	Familje	7,012
•	Institucione	235
5	Tarife per linjat ajerores nentokesore (Kablloret)	1,964
IV	Te ardhura te tjera	46,417
1	Te ardhura nga parkimi	2,744
2	Te tjera tarifa(Ambjenti)	1,226
6	Debitore Familje	19,886
7	Debitore Biznesi	22,561
TOTALI		360,900

PASQYRA E TË ARDHURAVE NË PBA 2026-2028

Të dhënat në 000/lekë

Tabela 47

Nr	Emertimi/Muaji	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028
I	Taksa mbi te ardhurat personale	18,000	18,540	19,096
II	Taksat vendore	232,793	239,346	245,970
1	Takse tabelë	1,986	2,045	2,107
•	Tabelë për qëllime identifikimi	1,585	1,632	1,681
•	Tabelë për qëllime reklamimi	401	413	426
2	Te ardhura nga zënia e hapsirave publike	15,775	16,249	16,736
3	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	84,342	86,872	89,478
4	Takse fjetje ne hotel	7,216	7,432	7,655
5	Takse mbi token bujqesore	18,433	18,555	18,555
6	Takse e mjeteve te perdorura	42,183	43,448	44,752
7	Takse e kalimit te se drejtes se pronesise pronësisë	3,311	3,411	3,513
8	Takse mbi ndertesat	51,460	53,004	54,594
9	Takse Trualli	8,087	8,330	8,580
III	Tarifat vendore	224,029	224,463	224,910
1	Tarife e pastrimit	107,434	107,434	107,434
2	Tarife e ndriçimit publik	48,606	48,606	48,606
3	Tarife gjelberimi publik	41,799	41,799	41,799
4	Tarife Arsimit	11,724	11,724	11,724
5	Tarifa urbanistike	754	777	754
6	Tarife per license/certifikate ne fushen e transportit rrugor	2,340	2,410	2,483
7	Tarifa per zënie salla dhe dhenie ambjentesh me qera	30	31	32
8	Tarifa te sherbimit te varrimit	6,380	6,571	6,769
9	Tarife per lende drusore	80	82	85
10	Tarife Ujitje	1,535	1,581	1,628
11	Tarife ambjenti	1,226	1,263	1,301
12	Taksa e rentës minerare	180	185	191
13	Tarife Urbanistike (kablloret)	1,964	2,022	2,083
IV	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	23,350	24,051	24,772
1	Te ardhurat per regjistrim	965	994	1,024
2	Te ardhura nga konviktet	2,980	3,069	3,161
3	Te ardhura nga kopshtet dhe cerdhet	19,405	19,987	20,587

V	Te ardhura te tjera	148,310	145,575	141,999
1	Te ardhura nga parkimi	2,744	2,826	2,911
2	Te ardhura nga qerate	26,710	27,511	28,336
3	Te tjera te ardhura nga pronesia	65,789	65,789	65,789
4	Te tjera debitore dhe gjyqe	5,900	6,195	6,505
5	Debitore Biznes + Familje	42,447	38,392	33,451
6	Te ardhura nga parkingu	3,650	3,760	3,872
7	Te tjera te ardhura nga biletat "PARKU DUA TE LUAJ"	420	433	446
VI	Te ardhura nga MZSH	650	670	690
VII	Te ardhura te pritshme nga bashkefinancimet e huaja	-	-	-
TOTAL		646,482	651,974	656,747

3.1.2 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

Me shkresën nr 15867 prot datë 06.11.2025 “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026” është bërë komunikimi nga Ministria e Financave në lidhje me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme për vitin 2026.

Për Bashkinë Berat është parashikuar kjo ndarje e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme:

vlerat paraqiten në: ALL

Burimet Buxhetore		2025	2025	2026	2027	2028
		Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Plani	Plani	Plani
TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME		545,223,748	545,223,748	611,514,899	650,626,784	685,489,112
1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	476,758,507	476,758,507	520,520,171	559,632,056	594,494,384
2	Rritja e nivelit të pagave	68,465,241	68,465,241	90,994,728	90,994,728	90,994,728

krahasimi me vitin paraardhës	2026-2025	2027-2026	2028-2027
ndryshimi/rritja në lekë	66,291,151	39,111,885	34,862,328
ndryshimi/rritja në %	12.2%	6.40%	5.36%

Për vitin 2026 transferta e pakushtëzuar e përgjithshme është 520,520,171 lekë , të cilës i shtohet edhe transferta për rritjen e nivelit të pagave 90,994,728 lekë, në total 611,514,899 lekë. Në krahasim me vitin 2025 transferta është parashikuar me rritje + 66,291,151 lekë, ose + 12.2 % .

Për vitin 2027 transferta e pakushtëzuar e përgjithshme është 559,632,056 lekë , të cilës i shtohet edhe transferta për rritjen e nivelit të pagave 90,994,728 lekë, në total 650,626,784 lekë.

Në krahasim me vitin 2025 transferta është parashikuar me rritje + 39,111,885 lekë, ose + 6.4 %. Transferta për rritjen e nivlit të pagave parashikohet e njëjtë me vitin 2026.

Për vitin 2028 transferta e pakushtëzuar e përgjithshme është 594,494,384 lekë, të cilës i shtohet edhe transferta për rritjen e nivelit të pagave 90,994,728 lekë, në total 685,489,112 lekë.

Në krahasim me vitin 2027 transferta është parashikuar me rritje + 34,862,328 lekë, ose +5.36 %. Transferta për rritjen e nivlit të pagave parashikohet e njëjtë me vitin 2026 dhe 2027.

3.1.3 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

Me shkresën nr 15867 prot datë 06.11.2025 “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026” është bërë komunikimi nga Ministria e Financave në lidhje me transfertën e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2026.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2026 është 401,315,775 lekë, për vitin 2027 dhe 2028 është parashikuar e pandryshuar.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë deri në vitin 2024. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.

1. *Konviktet e arsimit parauniversitar:* përfshihen fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukatore), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime për vitin 2025 janë parashikuar fonde në shumën 31,137,429 lekë. Për vitet 2026, 2027 transferta sektoriale është parashikuar e pandryshuar.

2. *Arsimi parashkollor:* për vitin 2026 janë parashikuar fonde në vlerën 172,156,073 lekë për personelin mësimor dhe 65,314,720 lekë për stafin mbështetës. Për vitet 2026, 2027 transferta sektoriale është parashikuar e pandryshuar.

3. *Arsimi parauniversitar:* për vitin 2026 janë parashikuar fonde në shumën 21,215,770 lekë. Për vitet 2026, 2027 transferta sektoriale është parashikuar e pandryshuar.

4. *Mbrojtja nga zjarri:* për vitin 2026 transferta e pakushtëzuar është 46,480,711 lekë. Në këto fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për vitet 2026, 2027 transferta sektoriale është parashikuar e pandryshuar nga viti 2026.

.

5. *Mbrojtja sociale*: për vitin 2026 janë parashikuar fonde në shumën 26,994,085 lekë, për funksionimin e Qendrës “Lira”. Në këto fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për vitet 2026, 2027 transferta sektoriale është parashikuar e pandryshuar.

6. *Rrugët rurale*: për vitin 2026 janë parashikuar fonde në vlerën 6,362,134 lekë. Për vitet 2026, 2027 transferta sektorale është parashikuar e pandryshuar.

7. *Administrimi i pyjeve*: për vitin 2026 janë parashikuar fonde në vlerën 8,336,963 lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për vitet 2026, 2027 transferta sektorale është parashikuar e pandryshuar nga viti 2026.

8. *Ujitja dhe kullimi*: për vitin 2026 janë parashikuar fonde në vlerën 18,820,228 lekë. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për vitet 2026, 2027 transferta sektorale është parashikuar e pandryshuar nga viti 2026.

Niveli i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për bashkinë Berat për periudhën 2026 -2028

vlerat paraqiten në: ALL

	Burimet Buxhetore	2025	2025	2026	2027	2028
		Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Plani	Plani	Plani
TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE		362,071,054	362,071,054	401,315,776.00	401,315,776	401,315,776
1	Konviktet e arsimit parauniversitar	30,230,514	30,230,514	31,137,429.00	31,137,429	31,137,429
2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimit	160,068,999	160,068,999	172,156,073.00	172,156,073	172,156,073
3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	50,968,345	50,968,345	65,314,720.00	65,314,720	65,314,720
4	Arsimi parauniversitar	17,476,556	17,476,556	21,215,770.00	21,215,770	21,215,770
5	Mbrojtja nga zjarri	46,480,711	46,480,711	50,978,373.00	50,978,373	50,978,373
6	Mbrojtja sociale	26,207,850	26,207,850	26,994,085.00	26,994,085	26,994,085
7	Administrimi i pyjeve	6,999,775	6,999,775	8,336,963.00	8,336,963	8,336,963
8	Rrugët	6,174,982	6,174,982	6,362,135.00	6,362,135	6,362,135
9	Ujitja dhe Kullimi	17,463,322	17,463,322	18,820,228.00	18,820,228	18,820,228
	krahasimi me vitin paraardhës	2026-2025		2027-2026	2028-2027	
	ndryshimi/rritja në lekë	39,244,722		0	0	
	ndryshimi/rritja në %	10.8%		0	0	

3.1.4 Transferta të Kushtëzuar për funksione të deleguara.

Transferta e kushtëzuar në buxhetin e vitit 2026 jepet për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara, shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për kryerjen

e shërbimit të Gjendjes Civile. Këto fonde do të përdoren nga bashkia vetëm për qëllimin për të cilin akordohen.

Për buxhetin e vitit 2026 transferta e kushtëzuar që do të akordohet për Bashkinë Berat do konfirmohet nga Ministritë e linjës në nisje dhe gjatë vitit 2026.

3.1.5 Fonde për Ndhmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore.

Fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesjen shoqërore, janë fonde të Ministrisë së linjes. Ato iu delegohen njësitë të qeverisjes vendore të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave si dhe kryejnë pagesat e ndihmës ekonomike, të personave me aftësi të kufizuar dhe për përkujdesjen shoqërore.

Për buxhetin e vitit 2025 transferta e kushtëzuar që do të akordohet për Bashkinë Berat, do të konfirmohet nga Ministritë e linjës në nisje dhe gjatë vitit 2026..

3.1.6 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe Programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale.

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.
2. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen në Nëntor të vitit paraardhës.
3. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin pasardhës buxhetor.

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.

Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimim e projekteve të reja kryhen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

3.2 PLANI I SHPENZIMEVE TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2026 DHE PERIUdhËN AFATMESME 2026 -2028

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet aktuale, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2023 deri në 2028.

Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

Vlerat paraqiten në : 000 lekë

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	585,536	644,165	845,640	850,851	956,572	966,136	975,800
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	501,269	552,930	725,194	729,828	819,978	828,176	836,459
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	84,267	91,234	120,446	121,024	136,594	137,960	139,341
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	357,700	444,946	485,298	621,923	506,971	530,715	543,108
602	Mallra dhe sherbime te tjera	313,290	345,965	312,804	443,320	328,171	348,271	357,808
603	Subvencionet	32,500	27,000	29,000	29,000	29,000	30,000	34,400
604	Transferime korrente te brendeshme	3,230	63,028	124,994	124,994	125,000	125,344	121,600
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	8,680	8,953	6,500	12,610	10,800	11,100	11,300
609	Rezervat	0	0	12,000	12,000	14,000	16,000	18,000
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	248,564	220,412	214,331	252,822	195,770	207,066	224,643
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	17,587	40,996	37,099	41,899	35,000	40,000	45,000
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	230,976	175,359	175,630	209,322	160,451	165,566	179,643
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	4,058	0	0	0	1,500	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	1,602	1,602	319	0	0

	Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0	0	0	0
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	0	0	0	0	0	0	0
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	0	0	0	2,789	3,506	6,890	651
602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	0	0	2,789	3,506	6,890	651
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0	0	0	0
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	0	0	0	0	0	0	0
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI		1,191,800	1,309,523	1,545,269	1,728,386	1,662,820	1,710,807	1,744,203

Struktura e shpenzimeve sipas natyrës për Bashkinë Berat pasqyron një politikë buxhetore të balancuar mes funksionimit operacional, garantimit të shërbimeve bazë dhe investimeve kapitale. Plani për vitin 2026 arrin në një total prej 1.662 miliard lekësh, me rritje të moderuar dhe të qëndrueshme krahasuar me vitet e mëparshme.

Krahasimi midis Planit 2026 dhe Fillestarit 2025 tregon se struktura e buxhetit për vitin 2026 ka një zhvendosje të qartë drejt shpenzimeve të personelit, të cilat rriten me rreth 13%, duke reflektuar harmonizimin e pagave, dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore.

Shpenzimet korrente të tjera paraqesin një rritje të moderuar prej 4.5%, e përcaktuar nga rritja e kostove të mirëmbajtjes dhe shërbimeve bazë.

Nga ana tjetër, shpenzimet kapitale ulen me rreth 8.7%, duke sinjalizuar përfundimin e projekteve dyvjeçar “Ndërtim i shkollës “Babë Dudë Karbunara”, dhe një qasje më konservatore ndaj investimeve të reja.

Në tërësi, buxheti 2026 paraqet një strukturë të balancuar dhe të kujdesshme, duke garantuar stabilitet financiar dhe forcim të shërbimeve ndaj qytetarëve.

3.2.1 PLANI I SHPENZIMEVE SIPAS NDARJES EKONOMIKE

Plani i shpenzimeve të vitit 2026 prej 1,662,819,592 lekë sipas ndarjes ekonomike :

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 956,572,000 lekë, për 816 punonjës. Në krahasim me planin e vitit 2025 janë planifikuar me rritje, kjo për shkak të ndryshimit të nivelit të pagave me 10,000 lekë/muaj për punonjësit mbështetës, si edhe indeksimin me 5,000 lekë/muaj për specialistët, në përputhje me programin e qeverisë. Numri i punonjësve mbetet i pandryshuar, në total 816.

Shpenzimet e personelit zënë 57.5 % të buxhetit total të vitit 2026.

Numri i Punonjësve sipas Programeve të dhe Njësive Shpenzuese të Bashkisë Berat

BV5 - Numri i Punonjësve sipas Programeve të NJVQV					
Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	2025	2026	2027	2028
AA102	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse	87	88	88	88
AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile	170	166	166	166
AC102	Arsimi dhe Kujdesi Social	391	391	391	391
AD102	Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore	45	45	45	45
AE102	Siguria dhe Mbrojtja e Territorit	72	75	75	75
AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet	51	51	51	51
AG102	Rezerva & Kontigjenca	0	0	0	0
Totali		816	816	816	816
BV5 - Numri i Punonjësve sipas Njësive Shpenzuese të NJVQV					
Kodi Buxhetor i Njësive Shpenzuese	Emërtimi i Njësive Shpenzuese	Numri i Punonjësve të Përhershëm		Numri i Punonjësve me Kontratë	
2102001	Bashkia Berat (0202)	213		0	
2102004	Nd-ja Komunale Banesa (0202)	158		0	
2102005	Qendra Ekonomike Arsimit (0202)	347		0	
2102006	Qendra Ekonomike Kultures (0202)	29		0	
2102020	Qendra Lira (0202)	24		0	
2102022	Drejtoria e Bujqësisë Administrimit të Pyjeve Ujërave dhe Shërbimit Veterinar (0202)	45		0	
Totali		816		0	

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 328,171,191 lekë. Në krahasim me vitin 2025 është planifikuar rritje 4% e këtyre shpenzimeve, por produkte të vecanta janë planifikuar me rritje, dhe të tjerë me rënie, duke u bazuar në ecurinë e viteve të mëparshme, duke vlerësuar zgjidhjen e nevojave aktuale, dhe duke synuar përmirësimin e cilësisë të disa produkteve prioritarë.

Shpenzimet operative për mallra dhe shërbime zënë 19.7 % të buxhetit total të vitit 2026.

Subvencion (art. 603) janë planifikuar në shumën 29,000,000 lekë. Këto shpenzime përfaqësojnë shumën e subvencionuar për sh.a. “FK Tomori 1923”, ku Bashkia Berat zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë. Transferimi i fondeve bëhet sipas kërkesave të paraqitura çdo muaj nga sha FK Tomori 1923 për financimin e shpenzimeve të domosdoshme.

Në krahasim me vitin 2025 shpenzimet janë planifikuar në të njëjtin nivel.

Shpenzimet për subvencion zënë 1.7 % të buxhetit total të vitit 2026.

Transfertat e brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 125,000,000 lekë.

Në transfertat e Bashkisë Berat përfshihen :

- ✓ Pagesa ndaj Berat City Green sha, shoqëria aksionere në pronësi 100% të bashkisë, për shërbimin e Menaxhimit të Mbetjeve, shërbim i cili ka filluar të ofrohet që nga 28 Prilli i vitit 2024, i miratuar me vendim të këshillit bashkiak.
- ✓ Detyrim kontraktual ndaj Ndërmarrjes Ujësjiellës-Kanalizime në rolin e agjentit tatimor për arkëtimin e tarifave vendore nga familjet nëpërmjet faturës mujore të ujit.
- ✓ Transfertë për Këshillin e Qarkut (kuotë), planifikuar sipas ligjit 68/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 38 pika 3.
- ✓ Transfertat për Shoqatën për Autonomi Vendore
- ✓ Transferta për Akademinë e Pushtetit Vendor

Në kuadër të iniciativës së përbashkët Qeveri Vendore dhe Qeveri Qendrore, për fuqizimin e kapaciteteve të Njësive të Qeverisjes Vendore, dhe në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr.6 datë 12.01.2024 “ Për ngritjen e grupit ndërinstitucional për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të njësive vendore”, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Qeverisjes Vendore, do të zbatojnë funksionimin në vitin 2026 të “Akademisë për Pushtetin Vendor”. Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës për Autonomi Vendore, do të jetë organizmi që do të kooordinojë Akademinë. Sipas dakordësisë ndërmjet palëve, është rënë dakord, që Qeveria Qendrore, të kontribuojë për ngritjen e Akademisë së Pushtetit Vendor me 50% të shumës së buxhetit dhe Bashkitë më 50% të shumës.

Sipas përlllogaritjes së numrit të punonjësve të Bashkisë Berat, kuota e Bashkisë Berat për vitin 2026 për Akademinë do jetë në shumën 836,426 lekë.

Akademia do të shërbejë për ngritjen e kapaciteteve të stafit, trajnime, mbështetje ligjore dhe dhënie informacioni për funksionet e Bashkive.

Gjithashtu, bazuar në Statusin e Shoqatës për Autonomi Vendore, neni 24 , ku Bashkia Berat aderon, dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues të Shoqatës për Autonomi Vendore të datës 07.12.2015 “Mbi kuotat e anëtarësisë së bashkive në Shoqatë”, Bashkia Berat do të kontribuojë me kuotën vjetore të anëtarësisë për vitin 2026 prej 1,186,500 lekë, për Shoqatën për Autonomi Vendore.

Transfertat e brendshme zënë 7.5 % të buxhetit total të vitit 2026.

Transfertat për buxhete familjarë dhe individë (art. 606) janë planifikuar në shumën 10,800,000 lekë.

Në transfertat e Bashkisë Berat përfshihen :

Është programuar subvencionim të qirasë të familjeve të strehuara në banesat sociale të bashkisë, familjeve të cilat janë në kushte të vështira sociale dhe ekonomike me një vlerë të subvencionimit prej 1,800,000 lekë.

Përfshirja në skemën e përfitimit të subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për 50 familje me vlerë prej 7,000,000 leke, nga të cilat 50% do të perballohet nga buxheti i shtetit dhe 50% nga buxheti i bashkisë ose në vlerë 3,500,000 lekë. Përfitues të këtij programi janë familjet me probleme sociale dhe ekonomike, konkretisht familjet që kanë në përbërjen familjare persona me aftësi të kufizuar, gratë e divorcuara me fëmijë në ngarkim dhe familjet me të ardhura familjare mujore shume të ulëta, familjet e komunitetit Egjiptian e Rom etj

Është programuar fond për transferta tek familje në vështirësi ekonomike, për raste që trajtohen me ndihmë ekonomike nga bashkia, për raste fatkeqësish, të cialt administrohen nga drejtoria e shërbimit social të bashkisë . Fondi është në shumën 3,200,000 lekë.

Në lidhje me fondin e emergjencës dhe të mbrojtjes civile, bashkia do të trashëgojë fond për mbrojtjen civile në shumën 2,300,000 lekë, fond specifik i papërdorur , i cili do të shtohet në këtë zë pas mbylljes së vitit buxhetor 2026.

Në kete moment kemi planifikuar 2,000,000 lekë për ndihmë të familjeve në raste të emergjencave.

Parashikimi i fondeve për mbrojtjen civile bëhet në zbatim të ligjit 49/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 65 Buxheti i Bashkive, pika 1, sipas të cilit “Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, **të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.**”

Transferta specifike nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile do të akordohet në nisje të vitit 2026.

Transferrat për buxhete familjare dhe individë të planifikuara në këtë moment zënë 0.6% të buxhetit total të vitit 2026.

Rezervat dhe kontigjencat (art.609) . Në këtë zë përfshihen Fondi rezervë, fondi i kontingjencës


Fondi rezervë është parashikuar në shumën 7,000,000 lekë dhe Fondi i kontigjencës është parashikuar në shumën 7,000,000 lekë.

Rezervat dhe kontigjencat zënë 0.8% të buxhetit total të vitit 2026.

Shpenzime kapitale (art. 230&231&225) janë planifikuar në shumën 195,770,483 lekë. Në krahasim me vitin 2025 janë planifikuar me rënie 8.7%, pasi ka përfunduar financimi i shkollës “Babë Dudë Karbunara”..

Shpenzimet kapitale zënë 11.8 % të buxhetit total të vitit 2026.

Grafiku i buxhetit të shpenzimeve viti 2026 sipas natyrës ekonomike :



PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE KAPITALE (Investime nga fondet e bashkisë).

Investimet në total për njesitë e qeverisjes vendore përballohen nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore, transfertat e pakushtëzuar, nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve si dhe donatorë/partnerë.

Shpenzime kapitale për vitin 2026 janë planifikuar në shumën 195,770,483 lekë dhe zënë 12 % të buxhetit total të vitit 2026

Lista e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2028

Vlerat paraqiten në: ALL

Programi	Artikull	Emërtimi i projektit	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028
		Bashkia Qendra	180,970,483	195,366,368	213,443,446
AA102	231	Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim (Blerje pajisje zyre, pajisje IT, softëares ; Nderhyrje ne godina; etj.)	1,400,000	2,000,000	5,000,000
AA102	231	Mjet për shërbimet mbështetëse të bashkisë	2,000,000		

AA102	255	Shërbimi i Borxhit - Kredia e banesave sociale	319,000		
AB102	230	Hartim projekte, studime, oponenta teknike, VNM	35,000,000	40,000,000	45,000,000
AB102	231	Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime, kolaudime, shpronësime	36,852,483	85,866,368	92,443,446
AB102	231	Përmirësimi i banesave për komunitete të varfëra e të pafavorizuara, bashkëfinancim me MSH	10,000,000	15,000,000	15,000,000
AB102	231	Fond per Bashkefinancime ne projekte me financim te huaj ne fushen e sherbimeve publike	8,888,000	22,000,000	30,000,000
AC102	231	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" dhe parkim nëntokësor, bashkëfinancim me MAS (178.926.820 / 421.004.430)	83,911,000		
AC102	231	Fond per projekte dhe bashkefinancime ne fushen e arsimit parauniversitar	2,500,000		
AC102	231	Fond per projekte dhe bashkefinancime ne fushen e arsimit parashkollor		25,000,000	
AC102	231	Fond per projekte dhe bashkefinancime ne fushen e arsimit			20,000,000
AE102	231	Bicikleta per punonjesit e Policise Bashkiake - 4 cope	100,000		
AE102	231	Blerje pajisje speciale per MZSH	-	500,000	1,000,000
AF102	231	Fond per projekte dhe bashkefinancime ne fushen e sportit		5,000,000	5,000,000
		Agjencia e Sherbimeve Publike	2,500,000	2,500,000	2,000,000
AB102	231	Blerje tabela dhe kurriza artificial per sinjalistiken rrugore	1,700,000		
AB102	231	Blerje pajisje Kondicioner	120,000		
AB102	231	Blerje pajisje kompjuterike	380,000		
AB102	231	Puse per gjelberimin	300,000		
		Investime ne sherbimet publike (parqe, sinjalistike)		2,500,000	2,000,000
		Drejtoria e Arsimit	7,800,000	5,000,000	5,000,000
AC102	231	Ndertim Kendi sportiv shkolla Lapardha	3,020,120		
AC102	231	Hidroizolim Shkolla Roshnik	2,700,000		
AC102	231	Hidroizolim Kopshte	1,000,000		
AC102	231	Hidroizolim Cerdhe nr.5	1,079,880		

AC102	231	Investime ne Institucionet Arsimore		5,000,000	5,000,000
		Qendra "Lira"	500,000	200,000	200,000
AC102	231	Pajisje elektroshtepiake	120,000	200,000	200,000
AC102	231	Kondicioner per qendren ditore	120,000		
AC102	231	Pajisje zyre (dollap rrobash, arkive, poltron)	260,000		
		Drejtoria e Bujqesise	3,000,000	2,500,000	2,500,000
AD102	231	Veshje me beton në kanalet ujtese ne fshatin Starove	3,000,000		
AD102	231	Fond per investime ne fushen e bujqesise		2,500,000	2,500,000
		Qendra Kulturore "M. Tutulani	1,000,000	1,500,000	1,500,000
AF102	231	Funksionimi i Bibliotekës	1,000,000	1,500,000	1,500,000
		I. TOTALI i investimeve me fonde te Bashkise	195,770,483	207,066,368	224,643,446

Lista e projekteve të investimeve të financuara nga buxheti i shtetit (transfertë e kushtëzuar)

në lekë

Programi	Artikull	Emërtimi i projektit	viti i fillimit	viti i perfundimit	Vlera e Kontraktuar
AC102	231	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" dhe parkim nëntokësor, bashkëfinancim me MAS	2024	2026	421,004,430
AB102	231	Permiresimi i banesave per komunitete te varfera e te pafavorizuara (Bashkefinanc.) (Kontrata 2025-2026)	2025	2026	31,731,880
AC102	231	Rikonstruksion total i shkolles se mesme te bashkuar "Koco Brisku" Lapardha	2025	2026	53,810,266
AF102	231	Rikonstruksion i Qendres Rinore Lapardha	2025	2026	18,551,646
II.TOTALI i investimeve me fonde te Buxhetit te Shtetit dhe bashkefinancim me Bashkine					525,098,222

3.2.3 BUXHETI I VITIT 2026 DHE AFATMESEM 2026 -2028 PËR PROGRAMET BUXHETORE

Ky seksion i dokumentit paraqet planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për vitin 2025 dhe secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë.

Buxheti i vitit 2026 për programet buxhetore

Vlerat paraqiten në: ALL


Kodi	programi	Numri i Punonj esve	Pesha	Totali	Paga & Sigurime	Korente të Tjera	Kapitale
AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse	88	11.80%	196,273,000	142,318,000	50,236,000	3,719,000
AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile	166	31.32%	520,844,483	159,060,000	268,544,000	93,240,483
AC102	Arsimi & Kujdesi Social	391	36.85%	612,816,000	434,665,000	83,440,000	94,711,000
AD102	Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore	45	4.22%	70,163,328	48,797,000	18,366,328	3,000,000
AE102	Siguria dhe Mbrojtja e Territorit	75	6.66%	110,801,000	104,021,000	6,680,000	100,000
AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet	51	8.29%	137,921,781	67,711,000	69,210,781	1,000,000
AG102	Rezerva & Kontigjenca	0	0.84%	14,000,000	0	14,000,000	0
	Totali	816	100%	1,662,819,592	956,572,000	510,477,109	195,770,483

Buxheti i Bashkisë Berat për vitin 2026 është ndërtuar mbi parimin e balancës midis shërbimeve publike për qytetarët, investimeve në infrastrukturë dhe garantimit të funksionimit normal të institucioneve vendore. Totali i shpenzimeve arrin në **1,662,819,592 lekë**, me **816 punonjës** të shpërndarë sipas programeve të specializuara.

Struktura e buxhetit reflekton prioritetet strategjike të bashkisë: arsimi, shërbimet publike, mirëqenia sociale, mbrojtja e territorit dhe zhvillimi kulturor e turistik.

- Buxheti 2026 mbështetet në **fokus të fortë te shërbimet bazë**: pastrimi, arsimi, mirëmbajtja e rrugëve, ndriçimi dhe menaxhimi i territorit.
- **Arsimi & Shërbimet Publike** përthithin 68% të buxhetit total, duke reflektuar prioritetet kryesore të bashkisë.
- Investimet kapitale janë të orientuara drejt sektorëve me impakt të drejtpërdrejtë te qytetarët.
- Struktura financiare është e qëndrueshme, me raport të mirë mes pagave, korrenteve dhe kapitaleve.
- Shpenzime kapitale të moderuara në siguri publike dhe teknologji administrative.

Grafik : Buxheti 2026 sipas Programeve Buxhetore



Analizë e shkurtër sipas Programeve Buxhetore

AA102 – Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse

Pesha në buxhet: 11.80% | 88 punonjës

Ky program siguron funksionimin administrativ të bashkisë. Me **196.3 milion lekë**, nga të cilat **72.5% shkojnë për paga**, programi ruan një peshë të qëndrueshme. Rritja e kostove korrente lidhet me nevojën për trainimin e punonjësve në Akademisë së Pushtetit Vendor, mirëmbajtje, shërbime IT, shërbime kontraktuale dhe rritje të volumit administrative, shpenzime për pritje dhe përcjellje, etj.. Shpenzimet kapitale janë minimale (3.7 milion lekë), duke treguar fokus në eficiencë dhe jo në investime të reja.

AB102 – Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile

Pesha në buxhet: 31.32% | Programi më i madh i bashkisë | 166 punonjës

Me një total prej **520.8 milion lekësh**, ky program përfaqëson shtyllën kryesore të cilësisë së jetës në territor.

- **159 milion lekë paga**, strukturuar për sjelljen e shërbimeve 24/7;
- **268.5 milion lekë shpenzime korrente**, që pasqyrojnë kostot e pastrimit, mirëmbajtjes së rrugëve me asfalt, gjelbërimi, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve, shërbimit të dekorit;
- **93.2 milion lekë investime**, duke mbuluar ndërhyrje kapitale në infrastrukturën publike

AC102 – Arsimi & Kujdesi Social

Pesha në buxhet: 36.85% | Programi më i rëndësishëm social | 391 punonjës

Arsimi dhe shërbimet sociale përbëjnë programin më të madh në raport me numrin e punonjësve dhe shpenzimet e pagave. Nga **612.8 milion lekë** gjithsej:

- **434.6 milion lekë** janë paga – 71%, duke reflektuar rrjetin e gjerë të kopshteve, çerdheve dhe edukatorëve, si edhe numrin e lartë të personelit në arsimin parashkollor dhe parauniversitar
- **83.4 milion lekë** korrente;
- **94.7 milion lekë** investime për përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe sociale. Ky program ruan standardet e shërbimeve për fëmijët dhe kategoritë në nevojë, duke i orientuar investimet te shkollat, kopshtet dhe njësitë sociale.

AD102 – Bujqësia, Pyjet, Ujërat, Veterinaria & Siguria Ushqimore**Pesha në buxhet: 4.22% | 45 punonjës**

Program modest në vëllim, por thelbësor për zonat rurale.

Totali **70.1 milion lekë**, me strukturë:

- 48.8 milion lekë paga;
 - 18.3 milion lekë korrente për aktivitetet pyjore, ujore
 - 3 milion lekë investime.
- Programi ka natyrë operativo-teknike dhe ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen e ekosistemit.

AE102 – Siguria dhe Mbrojtja e Territorit**Pesha: 6.66% | 75 punonjës**

Me **110.8 milion lekë**, programi mbështet rendin vendor, inspektimet e territorit, detyrat e Policisë Bashkiake, veprimet për Mbrojtjen dhe Shpëtimin nga Zjarri

- 104 milion lekë paga (94% e totalit);
- Shpenzimet korrente dhe kapitale shumë të kufizuara, duke treguar se fokusi është te rritja e prezencës dhe zbatimi i rregullave në territor. Parashikohen shpenzime kapitale për policinë bashkiake, blerje bicikleta, ndërkohë që janë të plotësuar në mjete zjarrfikëse, pajisje dhe teknologj për shërbimet MZSH..

AF102 – Turizmi, Kultura dhe Sportet**Pesha: 8.29% | 51 punonjës**

Ky program ka një rol strategjik në transformimin ekonomik të Bashkisë Berat. Totali **137.9 milion lekë**, shpërndarë si vijon:

- **67.7 milion lekë** paga;

- **69.2 milion lekë korrente**, kryesisht për evente, festivale dhe mirëmbajtje objektsh kulturore;
- Investimet janë 1 milion lekë për blerje tituj libra, funksionimin e bibliotekës.

AG102 – Rezerva dhe Kontigjenca

Pesha: 0.84% | 14 milion lekë

Program pa staf, i krijuar për të mbuluar situata të paparashikuara financiare. Pesha është e balancuar dhe në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar.

3.2.3.1 PROGRAMI AA102: Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse

Përshkrimi i Programit		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse	• Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin; • Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjete, zyrave të printimit dhe IT etj; • Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë; • Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; • Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.
		• Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj; • Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.
		• Administrimi i fondeve të gjendjes civile • Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore; • Amortizimi i huave të marra etj.

Njësia Shpenzuese që menaxhon programin :

- Bashkia Berat (qendra)

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë Berat dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për mbarëvajtjen e punës në përmbushjen e funksioneve të përcaktuara në legjislacion.

Qëllimet e politikës së programit:

- Përmirësimi i funksionimit dhe menaxhimit të Bashkisë Berat, zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese dhe garantimi i përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore, ofrimi i shërbimeve cilësore dhe përdorimi me efektivitet i burimeve financiare të Bashkisë.
- Vendosja e standardeve të reja në menaxhimin e burimeve njerëzore mbi bazën e meritokracisë dhe profesionalizmit në rekrutimet në shërbimin civil dhe fuqizimi i kapaciteteve ekzistuese në mënyrë që t'i përgjigjen realizimit të vizionit për të ardhmen e qytetit.
- Ofrimi i shërbimeve cilësore komunitetit duke u bazuar në krijimin e kushteve optimale të punës dhe një klime motivimi dhe bashkëpunimi midis punonjësve, koordinimi dhe mirëkuptim midis palëve duke garantuar mbarëvajtje optimale të punës
- Krijimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me aktorët shtetërorë, shoqërinë civile vendase apo organizata ndërkombëtare e përfaqësi të vendeve të huaja
- Menaxhim i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm i borxhit
- Promovimin e qytetit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve sociale, artistike

Objektivat e politikës së programit:

- Menaxhim me efikasitet të Burimeve Njerëzore, për krijimin e një administrate vendore profesionale në bazë të meritës, aftësive dhe profesionalizmit, t'i përgjigjen standarteve më të larta që kërkojnë në Qeverisjen Vendore.
- Sigurimi i informimit të vazhdueshëm, transparent për publikun dhe mediat me qëllim krijimin e një mjedisi pozitiv komunikimi dhe bashkëpunimi institucion – komunitet, duke rritur nivelin e shërbimit cilësor për komunitetin.
- Kualifikimi në vijueshmëri i burimeve njerëzore.
- Nxitjen efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore.
- Rritja e cilësisë së jetës së qytetarëve
- Rritja e numrit të vizitorëve në qytet
- Ulja e borxhit
- Arkëtimi në kohë i të ardhurave të planifikuara dhe pakësimi i debitorëve
- Kryerja në kohë e pagesave dhe ulja e nivelit të borxhit (huasë)

Produktet që synohen të ofrohen:

- Plotësimi me burime njerëzore i të gjitha vendeve të lira sipas strukturës së miratuar në mbështetje të planit vjetor të rekrutimit sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi

- Përmirësim i funksionimit të zyrës me një ndalesë si në qendër ashtu edhe në Njësitë Administrative .
- Përmirësimi i infrastrukturës në lidhje me kushtet e punës (blerja e paisjeve kompjuterike për administratën dhe softëareve të nevojshme).
- Implementimi i sistemeve HRMIS, Administrata.al si pjesë e regjistrimit qendror të personelit të administratës vendore (me mbështetjen e DAP, ASPA Këshillit të Evropës, Qeverisë Zvicerane), pasi reforma në Administratë është një kusht i rëndësishëm për t'u përmbushur për hapjen e negociatave për në BE.
- Vazhdimi i funksionimit të sistemit E-PAV (platforma e administratës vendore) si një hallkë bashkëpunimi me ASPA për trajnimet e detyrueshme të nëpunësve civilë në periudhe prove.
- Përditësimi i sistemit të taksave (TAIS) me soft më bashkëkohor

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i parashikuar 2026 për programin AA102 Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse është 196,273,000 lekë dhe zë 11.8 % të buxhetit total të bashkisë.

Shpenzimet e Programit AA102 Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	109,908	89,534	132,313	126,983	142,318	143,741	145,178
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	94,286	76,645	113,379	108,849	122,125	123,346	124,579
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	15,622	12,890	18,934	18,134	20,193	20,395	20,599
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651)	30,441	50,257	43,014	70,852	50,236	66,255	70,847
602	Mallra dhe sherbime te tjera	26,856	47,072	39,014	66,322	46,230	61,905	66,447
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	4,400
604	Transferime korrente te brendeshme	3,230	3,155	4,000	4,000	4,006	4,350	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	355	30	0	530	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255, 1661)	11,464	13,629	5,102	3,102	3,719	2,000	5,000
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	11,464	9,572	3,500	1,500	3,400	2,000	5,000
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	4,058	0	0	0	0	0

255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	1,602	1,602	319	0	0
	Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0	0	0	0	0
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	0	0	0	0	0	0	0
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Korrente të Tjera (602, 604) (Huaja)	0	0	0	0	0	0	0
602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0	0	0	0	0
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patruazuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te truazuara	0	0	0	0	0	0	0
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI		151,813	153,421	180,429	200,937	196,273	211,996	221,025

Për vitin 2026:

Buxheti i vitit 2026 për programin AA102 Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse është planifikuar në shumën 196,273,000 Lekë, dhe zë 11.8 % të buxhetit total të bashkisë.

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 142,318,000 lekë, për 88 punonjës, dhe zënë 72.5 % të buxhetit të programit AA102.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime (art. 602) janë planifikuar në shumën 46,230,000 lekë, dhe zënë 24% % të buxhetit të programit AA102

Transferta e brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 4,006,000 lekë, dhe zënë 2 % të buxhetit të programit AA102.

Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 3,400,000 lekë, dhe zënë 2% të buxhetit të programit AA102.

Shpenzimet e vitit 2026 të programit AA102 Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse 196,273,000 Lekë do të financohen nga:

- Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme: 128,537,819 lekë
- Transferta e përgjithshme sektoriale: 0 lekë
- Të ardhurat e veta: 67,735,181 lekë

Për vitin 2027 shpenzimet e planifikuara të këtij programi janë 211,996,000 lekë, nga të cilat Shpenzime për paga & sigurime 143,741,000 , shpenzime korrente 66,255,000 lekë dhe shpenzime kapitale 2,000,000 lekë.

Për vitin 2028 shpenzimet e planifikuara të këtij programi janë 221,025,000 lekë, nga të cilat Shpenzime për paga & sigurime 145,178,000 , shpenzime korrente 70,847,000 lekë dhe shpenzime kapitale 5,000,000 lekë.

Shpenzimet analitike për mallra e shërbime të programit AA102

Vlerat paraqiten në: ALL

	Zerat e Shpenzimeve	PROGRAMI AA102 Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse						
Llogaria ekonomike	Emri i Produktit	Mirembajtja dhe permiresime infrastruktures fizike te Bashkise	Akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak	Subjekte tregtare të Inspektuara	Përmbushja e Detyrimeve Gjyqësore	Nëpunës të trajnuar	Transparenca publike	Plan 2026
	Kodi i Produktit	V111AAD	V111AAB	V112AAB	V111AAG	V111AAH	V360AAA	
6020100	Kancelari	1,000,000						1,000,000
6020200	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndricim	150,000						150,000
6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	500,000						500,000
6020500	Blerje dokumentacioni	450,000						450,000
6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme	100,000						100,000
6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale	50,000	50,000					100,000
6022001	Elektricitet	2,300,000						2,300,000
6022002	Uje	2,200,000						2,200,000
6022004	Posta dhe sherbimi korrier	1,450,000						1,450,000
6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	1,300,000						1,300,000
6022099	Sherbime rregjistrim pronash, njoftime ne media, te tjera sherbime nga te trete	500,000						500,000
6023100	Karburant dhe vaj	2,900,000						2,900,000
6023200	Pjese kembimi, goma dhe bateri	800,000						800,000
6023300	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	220,000						220,000
6023900	Shpenzime te tjera transporti	10,000						10,000
6024100	Udhetime e dieta					400,000		400,000
6025400	Shpenz.per miremb.e rrugeve, veprave ujore,rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	700,000						700,000
6025500	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes	1,200,000						1,200,000
6029001	Shpenzime per pritje e percejllje, perfaqesime						2,000,000	2,000,000
6029003	Shpenzime gjyqesore				10,000,000			10,000,000
6029005	Shpenzime per honorare	200,000						200,000
6029006	Shpenzime kompesimi per anetaret e Keshillit Bashkiak/ Kryetaret e fshatrave		16,100,000					16,100,000
6029099	Shpenzime per projekte festash ,aktivitete artistike,sociale,promovuese	50,000						50,000
6029099	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative							0

604	Transferta të Brendshme			4,006,000		1,600,000		5,606,000
602-606	Totali	16,080,000	16,150,000	4,006,000	10,000,000	2,000,000	2,000,000	50,236,000

Shënim : Në programin AA102 janë përfshirë shpenzime për aktivitetet e Këshillit Bashkiak

Nr	Emertimi i Shpenzimeve	Numri	Plan 2026
a.	Shpenzime personeli për këshillin	31	19,081
1	Shpërbllim për Këshillin (1/10 e pagës së kryetarit)(Honorare)	31	9,486
2	Sekretari i Këshillit(paga +sigurime shoqërore)	1	1,889
3	Specialist i Këshillit (paga +sigurime shoqërore)	1	1,096
4	Shpërbllim për Kryetarët e Fshatrave	36	6,610
b.	Shpenzime Operative (sipas planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak për 2026) (Artikulli 602)		520
1	Shpenzime për konsultime (seance konsultimi me bashkësinë, dëgjuesat publike, transparenca e informimit)		75
2	Shpenzime për dhurata ceremoniale (buqeta lulesh, kurora,)		64
3	Blerje çertifikata, karta, kartolina urimi për festat zyrtare		18
4	Shpenzime për mirëmbajtje pajisje kompjuterike		60
5	Kancelari zyre		103
6	Shpenzime për aleancën e grave këshilltare dhe nisma me baze ligjore		200
Totali i Shpenzime (a + b)			19,601

Buxheti për Këshillin Bashkiak : 19,601,000 lekë

Projektet e Investimeve të programit AA102

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT	BURIMI I FINANCIMIT	DATA E FILLIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT	KOSTO TOTALE	2023	2024	2025	2026	2027	2028
						FAKTI	FAKTI	BUXHETI	PLANI	PLANI	PLANI
Shpenzimet Kapitale sipas Projekteve											
P111AAM	Mjet për shërbimet mbështetëse të bashkisë	Financim i Brendshëm	1/1/2026	31/12/2026	2,000	0	0	0	2,000	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve					2,000	0	0	0	2,000	0	0
Shpenzimet Kapitale sipas Produkteve											
V111AAA	Shërbimi i Stafit të Administrim & Menaxhim (Blerje pajisje zyre, pajisje IT, softërares ; Nderhyrje ne godina; etj.)					0	0	1,500	1,400	2,000	5,000
V171AAB	Shërbimi i Borxhit - Kredia e banesave sociale					0	0	1,602	319	0	0

Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Produkteve	0	0	3,102	1,719	2,000	5,000
Totali i Përgjithshëm	0	0	3,102	3,719	2,000	5,000

Në këtë program përfshihen 3 projekte :

1. Kredia per banesat sociale 2014-2026, kësti vjetor i v.2026 , në shumën 2,603.44 euro.
Në bazë të marrëveshjes së nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Berat, për projektin “ Ndërtimi i Banesave me Qëllim social” , Bashkisë Berat i është disbursuar shuma e kredisë 587,707 Euro.

Në këtë marrëveshje janë përcaktuar kështu e shlyerjes së huasë sipas viteve, pra plani i amortizimit për periudhat 12/2014 – 07/2026.

Bashkia Berat i ka respektuar afatet e shlyerjes së detyrimeve sipas grafikut të përcaktuar.

Në fund të vitit 2025 detyrimi i mbetur pritet të jetë : 2,603.44 eur.

Në vitin 2026 është programuar kësti përfundimtar 2,603.44 eur .

- Shpenzime kapitale per administrim & menaxhim (Blerje pajisje zyre, pajisje IT, softëares ; Ndërhjyre në godina; etj.) në shumën 1.5 milion lekë.
- Blerje mjeti për shërbimet mbështetëse të bashkisë në shumën 2 milion lekë

Informacion mbi Programin AA102

		FUNKSIONI	TË PËRGJITHSH ME	2021	2022	2023	2024	2025
1	NUMRI TOTAL I NDERTESAVE QE ADMINISTROHEN NGA BASHKIA	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	37.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2	NUMRI I PUNONJESVE	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0.00	106.00	113.00	116.00	82.00	78.00
3	NUMRI I PJESMARESVE NE KESHILLAT BASHKIAKE	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0.00	30.00	29.00	31.00	31.00	31.00
4	NUMRI I KRYETAREVE TE FSHATRAVE	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0.00	36.00	35.00	35.00	36.00	36.00
5	NUMRI I PUNONJESVE	01120 - Çeshtjet financiare dhe fiskale	0.00	0.00	0.00	0.00	9.00	10.00
6	PROJEKTE TE FINANCUARA NGA DONATORE TE HUAJ	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0.00	5.00	2.00	2.00	3.00	0.00
7	PRITJE PERCJELLJE DELEGACIONI TE HUAJ DHE VENDAS	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe	0.00	11.00	15.00	18.00	20.00	20.00

		Administrimi						
8	KOHA E PERGJIGJES NDAJ ANKESAVE TE KOMUNITETIT (NE DITE)	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0.00	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00
9	INSPEKTIVE TATIMORE VJETORE	01120 - Çeshtjet financiare dhe fiskale	0.00	118.00	125.00	140.00	145.00	145.00
10	DITË TRAJNIMI NË TOTAL	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0.00	100.00	150.00	150.00	170.00	170.00

3.2.3.2 PROGRAMI AB102: SHËRBIMET PUBLIKE, INFRASTRUKTURA & EMERGJENCAT CIVILE

Vështrim i përgjithshëm		
SIGURIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE VENDORE		
Kodi i programit	Emri i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
AB 102	Shërbimet Publike , Infrastruktura dhe Emergjencat Civile	Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; • Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësive të vetëqeverisjes vendore; • Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve; • Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; • Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike; • Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore; Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike; • Zhvillimi, rregullimi dhe përmirësimi i standardeve të ndriçimit rrugor. • Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të

		grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; • Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; • Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; • Pastrimi i rrugëve, parqeve etj. • Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjes vendore; • Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore; • Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin		• Agjencia e Shërbimeve Publike • Bashkia Berat (qendra)

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i parashikuar 2025 për programin AB102 Shërbimet Publike , Infrastruktura dhe Emergjencat Civile është 520,844,483 lekë dhe zë 31.32 % të buxhetit total të bashkisë.

Shpenzimet e Programit AB102 Shërbimet Publike , Infrastruktura dhe Emergjencat Civile

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLEST AR 2025	RISHIKU AR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	95,131	103,425	141,070	140,425	159,060	160,651	162,258
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	80,762	89,589	120,882	120,237	136,295	137,658	139,035
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	14,369	13,837	20,188	20,188	22,765	22,993	23,223
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	205,457	255,870	262,444	349,328	268,544	270,544	273,150
602	Mallra dhe sherbime te tjera	204,908	192,429	138,250	221,595	140,250	142,250	144,250
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	59,873	120,994	120,994	120,994	120,994	121,600

605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	549	3,568	3,200	6,738	7,300	7,300	7,300
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	107,433	116,073	114,029	109,296	93,240	165,366	184,443
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patruazuara	17,587	12,472	37,099	41,899	35,000	40,000	45,000
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te truazuara	89,846	103,602	76,930	67,398	58,240	123,866	139,443
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	1,500	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	408,021	475,368	517,543	599,049	520,844	596,561	619,851

Për vitin 2026:

Buxheti i vitit 2026 për programin AB102 Shërbimet Publike , Infrastruktura dhe Emergjencat Civile është planifikuar në shumën 520,844,483 Lekë, dhe zë 31.3 % të buxhetit total të bashkisë.

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 159,060,000 lekë, për 166 punonjës, dhe zënë 30.5 % të buxhetit të programit AB102.

Shpenzime të tjera korrente (art. 602-609) janë planifikuar në shumën 268,544,000 lekë, dhe zënë 51.5 % të buxhetit të programit AB102, ndër të cilat:

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 140,250,000 lekë

Transferime korrente të brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 120,994,000 lekë. Ky zë shpenzimesh përfaqëson shërbimin e pastrimit në qytet dhe njësitë administrative, i cili realizohet nga subjekti Berat City Green sha, shoqëri aksionere në pronësi 100% të bashkisë.

Transferta për Familje & Individë (art 606) janë planifikuar në shumën 7,300,000 lekë. Shpenzimet shkojnë për bonusin e qerasë, për subvencionimin e qerasë së familjeve në vështirësi social-ekonomike.

Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 93,240,483 lekë, dhe zënë 18 % të buxhetit të programit AB102.

Shpenzimet e vitit 2026 të programit AB102 Shërbimet Publike , Infrastruktura dhe Emergjencat Civile, në total 520,844,483 lekë do të financohen nga:

- Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme: 212,356,900 lekë
- Transferta e përgjithshme sektoriale: 6,362,134 lekë
- Të ardhurat e veta: 302,125,449 lekë

Për vitin 2026 shpenzimet e planifikuara të këtij programi janë 596,561,000 lekë, nga të cilat shpenzime korrente 431,195,000 lekë dhe shpenzime kapitale 165,366,000 lekë.

Për vitin 2027 shpenzimet e planifikuara të këtij programi janë 619,851,000 lekë, nga të cilat shpenzime korrente 435,408,000 lekë dhe shpenzime kapitale 184,443,000 lekë.

Shpenzimet analitike për mallra, shërbime të tjera korrente të programit AB102 në lekë

Programi AB102											
Plani 2026											
Art.	Zërat e Shpenzimeve \ Kodi i Produktit	total	V452AAB	V452AAC	V626AAB	V626AAC	V626AAD	V626AAI	V626AAH	V644AAB	V644AAC
1. Agjencia e Shërbimeve Publike		140,000,000	29,100,000	30,000,000	4,000,000	27,800,000	3,000,000	2,000,000	100,000	37,000,000	7,000,000
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	2,480,000	-	-	-	480,000	2,000,000	-	-	-	-
6020100	Kancelari	120,000				120,000					
6020200	Materiale per pastrim, dezinfektim,	120,000				120,000					
6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyles.	-									
6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	120,000				120,000					
6020500	Blerje dokumentacioni	120,000				120,000					
6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre	-									
6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	500,000					500,000				
6021002	Plehra kimike, furnitura veterinare, farera,	700,000					700,000				
6021008	Materiale per mbrojtjen e tokes, bimeve	500,000					500,000				
6021099	Te tjera materiale dhe sherbime speciale, vegla pune	300,000					300,000				
6021	Materiale dhe sherbime speciale	34,720,000	-	-	-	720,000	-	-	-	29,000,000	5,000,000
6E+06	Elektricitet (Ndricimi rrugor Urban)	29,000,000								29,000,000	
6022001	Elektricitet (Ndricimi rrugor Rural)	5,000,000									5,000,000
6022002	Uje	600,000				600,000					
6022003	Sherbime telefonike Internet	120,000				120,000					
6022004	Posta dhe sherbimi korrier	-									
6023	Shpenzime transporti	22,200,000	16,700,000	-	-	5,500,000	-	-	-	-	-
6023100	Karburant	15,500,000	12,500,000			3,000,000					
6023100	Shpenzime vaj dhe lubrifikant	1,200,000	1,200,000								
6023200	Pjese kembimi, goma dhe bateri	4,500,000	3,000,000			1,500,000					
6023300	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	1,000,000				1,000,000					

6024	Shpenzime udhëtimi	100,000	-	-	-	100,000	-	-	-	-	-
6024100	Udhëtim i brendshëm.	100,000				100,000					
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	78,500,000	12,400,000	30,000,000	4,000,000	21,000,000	1,000,000	-	100,000	8,000,000	2,000,000
6025200	Shpenz. për mirëmb. Parkimeve Gorice, kala	2,000,000				2,000,000					
6025400	Shpenz. për mirëmb. e rrugëve, Asfalt Rural	30,000,000		30,000,000							
6025400	Shpenz. për mirëmb. e rrugëve, Asfalt Urban	18,000,000				18,000,000					
6025400	Shpenz. për mirëmb. e rrugëve, Materiale Ndërtimi	5,000,000	4,400,000				500,000		100,000		
6025400	Shpenz. për mirëmb. e rrugëve, Materiale Inerte	9,000,000	8,000,000			1,000,000					
6025400	Shpenz. për mirëmb. Blerje materiale elektrike	10,000,000								8,000,000	2,000,000
6025400	Shpenz. për mirëmb. Varrezave (blerje sete varresh)	4,000,000			4,000,000						
6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës	500,000					500,000				
6029	Shpenzime të tjera operative	2,000,000	-	-	-	-	-	2,000,000	-	-	-
6029099	Shpenzime për të tjera materiale Dekorimi i qytetit	2,000,000						2,000,000			
6061099	Të tjera transferuara tek individët	-									

Art.	Zërat e Shpenzimeve \ Kodi i Produktit	total	V066AAE	V510AAB	V510AAC	V510AAD	V510AAF	V066AAB	V091AAC
2. Bashkia Berat (qendra)		128,544,000	250,000	62,035,546	2,869,000	51,238,604	4,850,850	5,300,000	2,000,000
602	Mirëmbajtje e banesave sociale	250,000	250,000						
604	Mbledhje dhe Transportim i Mbetjeve nga Zonat Urbane	62,035,546		62,035,546					
604	Mbledhje dhe Transportim i Mbetjeve nga Zonat Rurale	2,869,000			2,869,000				
604	Pastrimi i Rrugëve dhe Parqeve	51,238,604				51,238,604			
604	Depozitimi dhe Trajtimi i Mbetjeve	4,850,850					4,850,850		
606	Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë , bonus qeraje	5,300,000						5,300,000	
606	Ndihme për rastet e fatkeqesive natyrore, emergjencave civile	2,000,000							2,000,000

Projektet e Investimeve të programit AB102 (shpenzimet kapitale në 000 lekë)

KODI	EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT	BURIMI I FINANCIMIT	DATA E FILLIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT	KOSTO TOTALE	2023	2024	2025	2026	2027	2028
						FAKTI	FAKTI	BUXHETI	PLANI	PLANI	PLANI
Shpenzimet Kapitale sipas Projekteve											
P452AAU	Hartim projekte, studime, oponenca teknike, VNM	Financim i Brendshëm	1/5/2024	31/05/2024	161,899	0	0	41,899	35,000	40,000	45,000
P452AAV	Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime, kolaudime, shpronësime	Financim i Brendshëm	1/1/2024	31/05/2031	264,243	0	0	49,081	36,852	85,866	92,443
P066AAB	Përmirësimi i banesave për komunitete të varfëra e të pafavorizuara, bashkëfinancim me MSH	Financim i Brendshëm	1/3/2024	31/12/2025	54,000	0	0	14,000	10,000	15,000	15,000
P626-BR-001	Fond per Bashkefinancime ne projekte me financim te huaj ne fushen e sherbimeve publike	Financim i Brendshëm	1/6/2024	31/12/2024	62,888	0	0	2,000	8,888	22,000	30,000
P644-BR-001	Bashkefinancim per projektin "Projekti i ndricimit publik eficient";	Financim i Huaj	1/1/2025	31/12/2025	377	0	0	377	0	0	0
P626ACU	Blerje pajisje kamera sigurie per ne ambientet publike (parkimi ne lagjet "Kala" dhe "Gorice", parku "Dua te luaj";	Financim i Brendshëm	1/3/2025	31/07/2025	500	0	0	500	0	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve					543,907	0	0	107,856	90,740	162,866	182,443
Shpenzimet Kapitale sipas Produkteve											
V626AAC	Blerje tabela dhe kurriza artificial per sinjalistiken rrugore					0	0		1,700		
V626AAC	Blerje pajisje Kondicioner					0	0		120		
V626AAC	Blerje pajisje kompjuterike								380		
V626AAD	Puse per gjelberimin								300		
V626AAC	Blerje tabela dhe kurriza artificial per sinjalistiken rrugore					0	0	120		1,500	500
V626AAD	Blerje pajisje zyre dhe informatike					0	0	1,320		1,000	1,500
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Produkteve						0	0	1,440	2,500	2,500	2,000
Totali i Përgjithshëm						0	0	109,296	93,240	165,366	184,443

AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, në programin AB102, menaxhon buxhetin e shërbimeve publike :

- ✓ **Ndriçimi publik**
- ✓ **Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve**
- ✓ **Mirëmbajtja e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve**
- ✓ **Gjelbërimi dhe dekori i qytetit**

NDRIÇIMI PUBLIK - PUNIMET QË PARASHIKOHEN TË REALIZOHEN GJATË VITIT 2026

Rajoni Nr 1

- Mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të ndriçimit publik.
- Të tjera sipas kërkesave.

Rajoni Nr. 2

- Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit në Lulishtet e qytetit dhe Bulevardin kryesor .
- Lagjja “10 Korriku”, rruga “At Theodhori”
- Lagjja “13 Shtatori”, rruga “Shën Dëlliu”
- Lagjja “30 Vjetori” Komuniteti rom
- Të tjera sipas kërkesave .

Rajoni NR .3

- Mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të ndriçimit publik.
- Të tjera sipas kërkesave .

NJËSIA ADMINISTRATIVE OTLLAK

- Mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të ndriçimit publik .
- Të tjera sipas kërkesave.

NJËSIA ADMINISTRATIVE SINJË

- Mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të ndriçimit
- Të tjera sipas kërkesave .

NJËSIA ADMINISTRATIVE VELABISHT

- Fshati Bilçë, shtimi i hapësirës së sipërfaqes së ndriçimit.
- Fshati Duhanas, shtimi i hapësirës së sipërfaqes së ndriçimit.
- Fshati Drobonik, shtimi i hapësirës së sipërfaqes së ndriçimit.
- Fshati Veterik, shtimi i hapësirës së sipërfaqes së ndriçimit
- Të tjera sipas kërkesave

NJËSIA ADMINISTRATIVE ROSHNIK

- Mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të ndriçimit.
- Fshati Mimas + Qatollar , shtimi i hapësirës së sipërfaqes së ndriçimit.
- Fshati Rabjak, shtimi i hapësirës së sipërfaqes së ndriçimit, 6 ndriçues të rinj.
- Fshati Karkanjoz vendosje e 10 ndriçuesve të rinj.
- Fshati Bogdan vendosje e ndriçimit rrugor gjatë rrugës kryesore.
- Fshati Roshnik vendosje e 2 ndriçuesve të rinj.
- Fshati Vojnik vendosje e 5 ndriçuesve të rinj.
- Fshati Kostren vendosje e ndriçuesve gjatë rrugës kryesore.
- Fshati Qafë-Dardhë vendosje e ndriçuesve gjatë rrugës kryesore
- Të tjera sipas kërkesave .

MIRËMBAJTJA E RRUGËVE : PUNIMET QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN GJATË VITIT 2026 SIPAS RAJONEVE DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE NË BASHKINË BERAT

Rajoni Nr.1

Mirëmbajtje trotuari me pllaka betoni në rrugën “Antipatrea” 65 m² pllakë trotuari nga “Ypsiloni” deri tek “Gjashtëkatëshi” .

Shtrim Rrugë me Asfalt.

- Rruga “Çikrikët” me gjatësi 1000 ml.
- Rruga “Nezir Frakulli” me gjatësi 235 ml.
- Rruga “Qemal Pulake” pjesa e mbetur rreth 300 m².

Shtrim Rrugë me beton.

- Riparim i rrugës “Agron Elezi” me pllaka betoni 120 ml.
- Riparim puseta KUL dhe vendosje kapakësh të rinj.
- Linja te ujërave të shiut me tub fi 200,300.
- Vijëzime për këmbësorët në vendet e përcaktuara si Shkolla dhe rrugë kalimi për këmbësorë.

Rajoni Nr.2

Shtrim Rrugë me Asfalt.

- Lagjja “13 Shtatori” 500 ml
- Lagjja “13 Shtatori” 700 ml
- Rruga “Kurt Pasha” 300 ml

Mirëmbajtje rruge me çakëll mbeturinë 2300 m² ose 230 m³

Ndërtim dhe riparim Kalldrëmi.

- Rruga “Veri Zalosnjë” 40 m² .
- Lagjja “13 Shtatori” 100 ml

Riparim Sheshi me Pllaka Betoni.

- Pllakë trotuari Rajoni N.2 .

Mirëmbajtje Puseta KUL.

- Riparim puseta dhe vendosje Kapakësh të rinj
- Vijëzime për këmbësorët në vendet e përcaktuara si shkolla dhe rrugë kalimi për këmbësorë.

Rajoni Nr.3

- Riparim Kalldrëmi në rrugën “Berberi” rreth 150 m² .
- Ndërtime sheshe me pllakë trotuari .
- Sheshi pranë ish - Maternitetit rruga “Kondas” 90 m² pllakë trotuari.
- Rruga “Xhovan Doga” me sip 400 ml ose 1,200 m²

Mirëmbajtja e Rrugëve (Riparim) me asfalt.

-Lagjja “Donika Kastrioti” 2500 m²

-Rruga “Pavarësia” Rajoni N.3 140 m² .

-Rrugë të brendshme në rrugën “Pavarësia” dhe “Qyperlinjtë” 800 ml ose 4000 m².

- Lagjja “Donika Kastrioti” 500 ml ose 1,750 m²
- Lagjja “Jani Vruho” 630 ml ose 2,205 m²
- Lagjja “Kushtrim” 850 ml ose 2,975 m²
- Lagjja “Uznovë” 1,750 ml ose 6,125 m²

Riparim Sheshi me Pllaka Betoni

-Shtrim rruge me beton në Lagjen “Kushtrim” , Rruga “Tom Karadaku” 70 ml dhe rruga “Xhovan Zoga” 300 ml.

Mirëmbajtje Puseta KUL

-Riparim puseta dhe vendosje Kapakësh të rinj -18 Copë në segmentet e dëmtuara.

Njësia Administrative Velabisht

Mirëmbajtje me beton

- Rruga e Varrezave Veterik 300 ml ose 900 m²
- Veterik 100 ml ose 300 m²
- Malinat 100 ml ose 300 m²
- Drobonik 150 ml ose 450 m²
- Duhanas – Kanacve 60 ml ose 180 m²
- Gjeroven 150 ml ose 450 m²
- Veleshnje 200 ml ose 600 m²

Ndërtim segmente me beton.

-Ndërtim segmenti me beton 200 ml në Fshatin Remanicë segment i vështirë.

Mirëmbajtje rruge me çakëll mbeturinë.

Nr	Fshati	Mirëmbajtje në ml	Mirëmbajtje në m ²	Sasia në m ³
1	Velabisht	500	1500	150
2	Starovë	1500	4500	450
3	Remanicë	1500	4500	450
4	Veterrik	2000	6000	600
5	Duhas	1500	4500	450
6	Palikësht	500	1500	150
7	Gjoroven	1000	3000	300
8	Veleshnje	500	1500	150
9	Bardhaj	1000	3000	300
10	Bilçë- Malinat	4000	12000	1200
	Totali	14000 ml	4200m²	4200 m³

Mirëmbajtja e Rrugëve (Riparim) me asfalt sipas kërkesave të administratorëve .

Nr	Emërtimi	ml	m2
1	Fshati Velabisht	800	2,560
2	Fshati Starove	2,200	7,700
3	Fshati Remanice	1,800	6,300
4	Fshati Veterrik	300	1,050
5	Fshati Bilce	600	2,100
6	Bilce /Malinat	13,000	45,500
7	Fshati Drobonik	200	700
8	Fshati Duhas	160	560
9	Gjoroven/ Veleshje	8,000	40,000
10	Gjoroven Fshat	300	900

Njësia Administrative Otllak

Mirëmbajtje rruge.

Ndërtim segmente me beton.

- Në Fshatin Qereshnik 200 ml beton ose 800 m²
- Vodëz Sipërme 350 ml ose 1120 m²
- Lapardha 2 150 ml ose 450 m²
- Qereshnik 200 ml ose 600 m²

Mirëmbajtja e Rrugëve (Riparim) me asfalt sipas kërkesës së Administratorit.

Nr	Emërtimi	ml	m2
1	Morave	1,750	5,250
2	Lapardha 2	1,100	3,300
3	Lapardha 1	1,700	5,100
4	Dyshnik	600	1,800
5	Orizaj	700	2,450
6	Otllak	600	2,100
7	Qereshnik	1,200	3,600
8	Ullinjas	500	1,500

Mirëmbajtje rrugë me çakëll mbeturinë.

Nr	Fshati	Mirëmbajtje me çakëll mbeturinë në ml	Mirëmbajtje me çakëll në m ²	Sasia çakëll mbeturinë në m ³
1	Orizaj	800	2500	250
2	Otllak	1200	3600	360
3	Moravë	2300	7800	780
4	Qereshnik	2000	6000	600
5	Dushnik	300	1000	100
6	Virion	500	1500	150
7	Vodëz	1000	3000	300
	Totali	8100 ml	25400 m²	2540 m³

Njësia Administrative Sinjë

1. Mirëmbajtja e Rrugëve (Riparim) me asfalt.

- Rruga kryesore Galinë – Sadovicë 1,000 ml ose 3,000 m²

2. Mirëmbajtje rruge.

- Do të vendosen 10 Tubo betoni, 5 copë në Sadovicë dhe 5 copë në Mbolan.

3. Ndërtim muri mbajtës.

- Ndërtim muri në Fshatin Levan ndërtim muri mbajtës të Rrugës 84 m³.

4. Mirëmbajtje dhe sistemim rruge me beton.

- Fshati Mbreshtan 50 ml ose 150 m²
- Fshati Mbolan 60 ml ose 180 m²
- Fshati Molisht 20 ml ose 60 m²

- Në Fshatin Mbjeshovë segment i Vështirë 150 ml.
- Në fshatin Mbolan 250 ml segmente të vështira.
- Në Fshatin Kamçisht 80 ml.

5. Mirëmbajtje rrugë me çakëll mbeturinë.

Nr	Fshati	Mirëmbajtje me çakëll mbeturinë në ml	Mirëmbajtje me çakëll në m ²	Sasia çakëll mbeturinë në m ³
1	Mbreshtan	800	2400	250
2	Galine	600	1800	360
3	Kamçisht	800	2400	780
4	Sadovice	1000	3000	600
5	Mbolan	2000	6000	100
6	Levan	2000	6000	150
7	Sinje	1000	3000	300
8	Mbjeshove	3000	9000	900
9	Osmezeze/Plashnik	3000	9000	900
10	Velcan	800	2400	240
	Totali	15000 ml	45000 m²	4500 m³

Njësia Administrative Roshnik

1. **Mirëmbajtja e Rrugëve (Riparim) me asfalt.**
 - Roshnik i vogël 1,500 ml ose 4,500 m²
2. **Mirëmbajtje dhe sistemim rruge me beton**
 - Rruga e Marrave 110 ml ose 330 m²
 - Lagja Pazjan 200 ml ose 640 m²
3. **Mirëmbajtje dhe sistemim rruge me Kalldrëm**
 - Rruga e Marrave 200 ml ose 700 m²

4. Mirëmbajtje rrugë me çakëll mbeturinë.

Nr	Fshati	Mirëmbajtje me çakëll mbeturinë në ml	Mirëmbajtje me çakëll në m ²	Sasia çakëll mbeturinë në m ³
1	Bogdan	2200	6600	600
2	Korce/Manastrec	1500	4500	450
3	Dardhë	3000	9000	900
4	Roshnik i vogël (Qatollare)	1000	3000	300
5	Vojnik	800	2400	240
6	Karkanjoz	400	1200	120
7	Mimias	200	600	60
8	Kostren	800	2400	240
	Totali	9900 ml	29700 m²	2970 m³

SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË VARREZAVE PUBLIKE DHE DËSHMORËVE

konsiston në shërbimet/aktivitetet e mëposhtme:

- **Ruajtje e varrezave publike.** Ky është një proces pune në vazhdimësi për gjatë gjithë vitit dhe përfshin ruajtjen e territorit të varrezave “Suelas“, “Burdullias“ dhe “Dëshmorëve të Kombit”. Ky zë nënkupton ruajtjen e varrezave publike dhe të Dëshmorëve të Kombit për 12 orë në ditë.
- **Pastrim dhe prerje bari 2 herë në vit.** Në këtë zë punimi nënkuptohet pastrim dhe prerja e barit 2 herë në vit në varrezat publike (përfshirë edhe NJA) dhe 1 herë në vit në varrezat e Dëshmorëve, me mjete korrëse dore dhe mjete motorike për transportin e barit. Ky proces pune do të realizohet gjatë muajve Maj-Gusht. Sipërfaqja totale e varrezave publike është 657,684 m² dhe sipërfaqja e varrezave të dëshmorëve është 4,190 m². Ky shërbim do të kryhet në varrezat publike për sipërfaqen 260,485 m², 2 herë në vit (total 520,970 m²); Në varrezat e dëshmorëve ky shërbim do të kryhet për sipërfaqen 1,610 m².
- **Ujitje bimësh dekorative.** Ky proces pune nënkupton ujitjen e bimëve dekorative dhe luleve në vazhdimësi, ujitje e cila do të kryhet në periudhën Prill-Tetor në varrezat “Suelas” dhe “Burdullias”. Sipërfaqja për të dyja varrezat për procesin e punës “Ujitje bimësh dekorative” është 1000 m².
- **Mirëmbajtje parcele ekzistuese.** Është një proces pune që ka të bëjë me riparimin e bordurave dhe shtrimin e rrugëve me çakull stabilizant. Është një punë që bëhet në vazhdimësi për gjatë gjithë vitit.
- **Mirëmbajtje lule dekorative.** Ky proces pune kryhet në varrezat e Dëshmoreve dhe nënkupton dy punime me bel, ujitjen e bimëve dekorative në vazhdimësi, 6 herë prashitje të sipërfaqes së mbjellë me lule dhe bimë dekorative, pastrimin në vazhdimësi të parcelave dhe largimin në vazhdimësi të mbeturinave të grumbulluara. Sipërfaqja e mbjellë me bimë dekorative dhe lule është 1610 m².
- **Pastrim rruge dhe sheshe.** Është një proces pune që bëhet gjatë gjithë vitit dhe nënkupton pastrimin e rrugëve dhe shesheve me fshesa dore, për varrezat ‘Suelas’, ‘Burdullias’ dhe ‘Dëshmorët’. Mbeturinat mbledhen me lopata plastike dhe grumbullohen edhe më pas largohen në vendet e paracaktuara nga Bashkia. Theksojmë se rrugët dhe hapësirat midis varreve në brendësi të varrezave të jenë vazhdimisht të pastra.
- **Rifreskimi i gërmave të varrezave të Dëshmorëve.** Është një proces pune që bëhet njëherë në vit, me varak (sprite). Mbas lyerjes bëhet pastrimi me naftë dhe beze tekstili i kokave të varrit me qëllim që të mos mbeten shenja varaku në përfundim të punës.
- **Pastrim varri prej mermeri në varrezat e Dëshmorëve** është një proces pune që kryhet dy herë në vit me materiale përkatëse në mënyrë të tillë që mos të dëmtohen varret apo të lihen shenja gërvishtje mbi sipërfaqjen e mermerit.

GJELBËRIMI

- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta duke shtuar mbjelljet e luleve, sipërfaqet me bar,

mbjelljet e pemëve dekorative , zëvendësimi i pemëve të thata në territorin e Bashkisë, si dhe Njësitë Administrative Otllak, Sinjë , Roshnik, Velabisht.

- Rehabilitimi i sistemit të ujitejes në Parkun Qëndror .
- Pastrimi nga barërat e keqinjtë në Rajonet e Bashkisë dhe shkollave të qytetit dhe Njësitë Administrative.
- Sistemimi i rrethrotullimeve me bar dhe lule.
- Sistemimi i tendave dhe këndeve çlodhës për moshën e tretë.
- Kompletimi me stola nëpër parqe dhe Njësitë Administrative.
- Vendosja e koshave të mbeturinave nëpër parqe.
- Sistemimi i sipërfaqes së re përballë varrezave të Suelasit sipas standarteve të legjislacionit për shërbimin e varrezave.

BASHKIA BERAT (qendra), brenda programit AB102, menaxhon buxhetin për:

- ✓ **Menaxhimi i Mbetjeve**
- ✓ **Strehimi Social**
- ✓ **Emergjencat Civile**

MENAXHIMI I MBETJEVE

Spektori i Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake pranë Bashkisë Berat (qendër) është përgjegjës për planifikimin e duhur dhe ofrimin e shërbimeve cilësore në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Përgjegjësia e sektorit ka të bëjë me ofrimin e të gjitha shërbimeve për mbetjet bashkiake—grumbullimi dhe transporti, fshirja dhe larja e rrugëve, edukimi mjedisor dhe asgjësimi final—në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare të menaxhimit të mbetjeve. Këto shërbime kryhen duke zbatuar politikat dhe strategjitë për të arritur menaxhimin në cilësinë më të lartë, në pajtim me standardet e BE për menaxhimin e mbetjeve bashkiake. Dhe ato synojnë në arritjen e objektivave dhe përmbushjen e rezultateve që kërkohen nga bashkia, përmes përdorimit eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare që janë në dispozicion.

Bashkia Berat, që nga 28 Prill 2024, e kryen Shërbimin e Pastrimit nëpërmjet Berat City Green sha, aksionet e të cilës zotërohen 100% nga bashkia

Në vitin 2025 u zgjidh problematika dhe nevoja për zgjerim të sipërfaqeve të mirëmbajtjes dhe pastrimit në zonat muzeale Mangalem, Goricë, Kala dhe Shtratin e Lumit Osum, realizimi i të cilit ka qënë një domosdoshmëri duke shkaktuar probleme me menaxhimin e mbetjeve.

Fluksi gjithmonë e në rritje i vizitorëve në qytet e bën të domosdoshëm shtrirjen e shërbimeve të pastrimit në lagjet muzeale dhe zonën e mbrojtur.

Shpenzimet e shërbimit të pastrimit për vitin 2026:

Për shërbimin e pastrimit janë programuar shpenzime 120,994,000 lekë, bazuar në koston vjetore të llogaritur sipas studimit të kryer nga ana e bashkisë Berat, miratuar edhe nga Këshilli Bashkiak Berat.

Shërbimet që do të kryhen për realizimin e menaxhimit të mbetjeve janë :

Nr.	EMERTIMI I SHERBIMEVE	Njësia	Volume ditore	Ditë sherbimi
			Njësi	
1	Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane dhe tregjeve (Berat) (kontenier 1m ³)	zbrazje/ditë	300	365
2	Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane dhe tregjeve (Otlak) (kontenier 1m ³)	zbrazje/ditë	60	208
3	Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane dhe tregjeve (Sinjë, Velabisht) (kontenier 1m ³)	zbrazje/ditë	89	104
4	Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane dhe tregjeve (Roshnik) (kontenier 1m ³)	zbrazje/ditë	30	104
5	Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë	m ² /ditë	180,050	365
6	Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike	ml/ditë	11,453	365
7	Mirëmbajtje rrugësh kryesore, trotuareve dhe shesheve	m ² /ditë	87,982	365
8	Larja me presion dhe solucion e Pedonales (2 herë/muaj) / 6 muaj	m ² /ditë	102	180
9	Lagje e rrugëve paradite (parashikuar për periudhën 15 Maj deri 15 Tetor)	m ² /ditë	117,321	150
10	Lagje e rrugëve mbasdite (parashikuar për periudhën 15 Maj deri 15 Tetor)	m ² /ditë	117,321	150
11	Transport i mbeturinave me krahë (karroce dore)	pika grumb/dt	81	365
12	Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve	copë/30 ditë	16	358
13	Sherbimet ne venddepozitim	dite sherbimi		365
14	Riciklimi	dite sherbimi		365
15	Sherbimet e pastrimit ne lagjet muzeale dhe shtratin e lumit	dite sherbimi		365

Theksojmë se në vitin 2026 do të vazhdojë të zbatohet skema e ndarjes në burim të mbetjeve për Beratin. Një praktikë novatore në menaxhimin e mbetjeve urbane, e nisur në vitin 2025, që heq dorë nga metodat e vjetra antimjedisore të deritanishme dhe përqafon standardet e BE-së. Berati është qyteti pioner që adapton një qasje të tillë të ndarjes së mbetjeve në burim, duke sjellë një ndryshim rrënjësor me impakt direkt tek mjedisi, por përtej mjedisit, tek aspekti social, shëndetësor.

STREHIMI SOCIAL

Buxheti i vitit 2026, shpenzimet korrente (llog. 602-606) për këtë funksion është planifikuar 5,550,000 lekë, konkretisht për produktet :

- V066AAB Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë e banesave shuma 5,300,000 lekë
- V066AAE Banesa sociale me qera të mirëmbajtura shuma 250,000 lekë

Bashkia Berat ka për qëllim t'u vijë në ndihmë familjeve në nevojë nëpërmjet subvencionimit të qerasë për familjet me të ardhura të ulëta , të cilat janë strehuar në banesat sociale të bashkisë , si edhe për familjet që kanë marrë banesa me qira në tregun e lirë, sipas nenit 33,34,38 të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social ". Gjithashtu të vazhdojë pjesëmarrjen në projektin "Për

subvencionimin e kredive me interesa të zbutura”, zbatuar nga Ministria e linjës dhe Bashkia Berat.

Berati është qytet që ka probleme me strehimin, jo vetëm në qytet por edhe në katër njësitë administrative, pasi ka një numër të madh familjesh të pastreha vetëm gjatë vitit 2025 kanë aplikuar për t'u trajtuar me programet e strehimit social rreth 250 familje. Përveç kësaj një numër i konsiderueshëm familjesh të komunitetit Egjiptian dhe Rom jetojnë në banesa të amortizuara të pabanueshme. të cilat janë bërë pjesë e projektit “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” projekt i cili është zbatuar nga ana jonë prej disa vitesh, nga viti 2021 e në vazhdim dhe synojmë që edhe për vitin 2026 të jemi pjesë e tij. Ky projekt është një bashkëfinancim me buxhetin e shtetit, ku bashkia mbulon vlerën e 30% të projektit, ndërsa 70 % mbulohet nga ministria e linjës.

Bashkia Berat e ka prioritet strehimin, edhe gjatë vitit 2026 dhe do të zbatojë disa projekte në këtë drejtim me synim zvogëlimin e numrit të familjeve të pastreha si dhe të problematikave në lidhje me strehimin. Ne do të vazhdojmë zbatimin e disa projekteve të cilat janë si më poshtë:

- Vazhdimi i pjesëmarrjes në projektin “Ndërtim banesash me kosto të ulët” në bashkëpunim me Entin Kombëtar të Banesave dhe Ministrinë e linjës..
- Menaxhimi i 48 apartamenteve të banesave sociale me qera.
- Përfshirja në skemën e përfitimit të subvencionim të qirasë në tregun e lirë familjeve për 50 familje me probleme sociale dhe ekonomike, konkretisht familjet që kanë persona me aftësi të kufizuar në përbërjen familjare, gratë e divorcuara me fëmijë në ngarkim dhe familjet me të ardhura familjare mujore shumë të ulëta, familjet e komunitetit Egjiptian e Rom etj. Vlera totale e këtij projekti është 7,000,000 lekë, nga të cilat 50% do të financohet nga buxheti i shtetit dhe 50% ose 3,500,000 lekë nga buxheti i bashkisë.
- Përfshirja në skemën e subvencionim të qirasë të 48 familjeve të strehuara në banesat sociale të bashkisë, familje të cilat janë në kushte të vështira sociale dhe ekonomike. Vlera e subvencionimit prej 1,700,000 lekë do të financohet nga buxheti i bashkisë.
- Përfshirja në skemën e subvencionimit të interesave të kredisë për 50 familje të pastreha ku Ministria e Ekonomisë e cila do të mbulojë interesat e kredise sipas akt-marrëveshjes së lidhur me Bankën Kombëtare Tregtare, Intesa San Paolo Bank dhe Raiffeisen Bank.
- Përfshirja në skemën e përfitimit të grantit të menjëhershëm, për familjet që janë trajtuar me banesë me kosto të ulët nga Enti Kombëtar i Banesave, apo subvencionim të interesave të kredisë dhe që kanë persona me aftësi të kufizuar, invalidë në përbërjen e tyre familjare. Fondi i grantit të menjëhershëm mbulohet nga Ministria e linjës që mbulon strehimin

EMERGJENCAT CIVILE

Buxheti i vitit 2026, shpenzimet korrente (llog. 602-606) për këtë funksion është planifikuar për produktet :

- V066AAB Familje në nevojë/Individë të subvencionuar për qeranë e banesave shuma 2,000,000 lekë

Të dhëna bazë mbi programin AB102 Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile

		FUNKSIONI	TË PËRSHM E	2021	2022	2023	2024	2025
1	NUMRI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00
2	NUMRI I VARREZAVE PUBLIKE QË ADMINISTRROHEN NGA BASHKIA	06260 - Shërbimet publike vendore	0.00	7.00	7.00	7.00	7.00	7.00
3	KM LINEAR TROTUARË PËR KËMBËSORË NË TOTAL	06260 - Shërbimet publike vendore	0.00	70,336.00	71,336.00	71,336.00	71,450.00	71,450.00
4	POPULLSIA TOTALE E BASHKISË	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0.00	99,793.00	99,694.00	99,694.00	99,694.00	99,694.00
5	SIPËRFAQE TOTALE PUBLIKE E BASHKISË NË KM2	01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0.00	380.00	380.00	380.00	380.00	380.00
6	SHPENZIME PËR MIREMBAJTJEN E RRJETIT RRUGOR (NË LEKË)	04520 - Rrjeti rrugor rural	0.00	29,579.00	43,340.00	107,000.00	82,567.00	105,000.00
7	SHPENZIME PËR DEKORE/FESTA NË LEKË NË VIT	06260 - Shërbimet publike vendore	0.00	933.00	1,697.00	2,000.00	16,551.00	1,200.00
8	SHPENZIME PËR NDRIÇIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE (NË MIJE LEKE)	06440 - Ndrëçimi i rrugëve	0.00	24,566.00	46,104.00	28,500.00	39,171.00	36,000.00
9	FONDI TOTAL I PEMËVE DEKORATIVE / GJELBËRUESE TË BASHKISË (RRENJE PEME)	06260 - Shërbimet publike vendore	0.00	0.00	4,521.00	753.60	4,000.00	1,200.00

3.2.3.3 PROGRAMI AC102 ARSIMI & KUJDESI SOCIAL

Vështrim i përgjithshëm

Mbështetja e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte. Mbështetja e arsimit të mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mësuesit. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat e trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhënia e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtësuar jetën e tyre të përditshme, integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre. Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Mbulimi i kostove për ofrimin e shërbimit të çerdhës pranë njësive vendore për fëmijët e moshës nga 0 deri në 3 vjeç. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta

Kodi i programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
AC 102	Arsimi & Kujdesi Social	Arsimi bazë përfshirë parashkollorin
		· Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës;
		· Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve;
		· Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve;
		· Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore.
		Arsimi i mesëm i përgjithshëm
		· Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore;
		· Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale;
		· Shpenzimet për paga për stafin mbështetës.
		· Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave;
		· Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.
		· Ndërtim dhe mirëmbajtje konviktesh.
		Përkujdesi social
		· Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari;
		· Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare;
		· Ndihmë financiare, asistencë për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës;
		· Strehë dhe ushqim dhënë fëmijëve dhe familjeve në mënyrë të përhershme (jetimore, familje kujdestare etj.);
		· Mallra dhe shërbime dhënë në shtëpi fëmijëve ose atyre që kujdesen për ta;
		· Shërbime dhe mallrat e ndryshme dhënë familjeve, të rinjve ose fëmijëve (qendra pushimi ose zbavitjeje);
		· Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore;
		· Shpenzimet për mbulimin e shërbimit të çerdheve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
		· Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktima të dhunës kriminale etj.);
		· Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situata të vështira;
		· Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si këshillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj;

	· Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar;
	· Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.);
	· Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor;
	· Përfitime në natyrë, si: vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në ambiente të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të personave të paaftë, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave të paaftë, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtuar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit;
	· Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore.
	· Administimi dhe mirëmbajtja e qendrave rezidenciale për të moshuarit;
	· Përfitime në para dhe në shërbime kundrejt rreziqeve të lidhura me moshën e tretë (humbje e të ardhurave, mungesë pavarësie në kryerjen e detyrave të përditshme, pjesëmarrje e ulur në jetën shoqërore dhe komunitare etj.);
	· Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore.
	• Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë të aftë për punë, të disponueshëm për punë, por janë të paaftë të gjejnë punësim të përshtatshëm;
	• Pagesa për grupe pjesë në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit që kanë për qëllim të zhvillojnë potencialin e tyre për punësim, kompensime për humbje të punës, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të papunët, në veçanti për të papunët afatgjatë;
	• Përfitime në natyrë, si pagesat për lëvizje dhe zhvendosje;
	• Trajnim profesional për personat pa punë ose ritrajnim për personat që rrezikojnë të humbin vendin e punës;
	• Akomodim, ushqim ose veshje dhënë personave të papunë dhe familjeve të tyre;

Programi AC102 Arsimit & Kujdesi Social menaxhohet nga njësitë shpenzuese :

- **Drejtoria e Arsimit**
- **Qendra “Lira”**
- **Bashkia Berat (qendra)**

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i parashikuar 2026 për programin AC102 Arsimit & Kujdesi Social është 612,816,000 lekë dhe zë 36.85 % të buxhetit total të bashkisë.

Shpenzimet e Programit AC102 Arsimit & Kujdesi Social

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	FILLESTAR 2025	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	292,123	318,136	383,589	384,519	434,665	439,011	443,403
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	250,339	272,641	329,083	329,863	372,498	376,222	379,985
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	41,783	45,495	54,506	54,656	62,167	62,789	63,418
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	48,485	57,927	80,019	82,237	83,440	85,460	87,400
602	Mallra dhe sherbime te tjera	41,197	52,716	76,719	77,117	79,940	81,660	83,400
603	Subvencionet	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0	0	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	7,288	5,211	3,300	5,120	3,500	3,800	4,000
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	95,182	63,604	85,000	113,579	94,711	30,200	25,200
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	11,436	0	0	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	95,182	52,168	85,000	113,579	94,711	30,200	25,200
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	435,789	439,667	548,608	580,335	612,816	554,671	556,003

Për vitin 2026:

Buxheti i vitit 2025 për programin AC102 Arsimit & Kujdesi Social është planifikuar në shumën 612,816,000 lekë dhe zë 36.85 % të buxhetit total të bashkisë.

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 434,665,000 lekë, për 391 punonjës, dhe zënë 70.9 % të buxhetit të programit AC102.

Shpenzime korrente të tjera (art. 602-609) janë planifikuar në shumën 83,440,000 lekë, dhe zënë 13.62 % të buxhetit të programit AC102, ndër të cilat :

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 79,940,000 lekë.

Transferta për Familje & Individë (art 606) janë planifikuar në shumën 3,500,000 lekë. Transferta e parashikuar 3,200,000 lekë shkon për rastet e familjeve dhe individëve në kushte të vështira ekonomike të cilat administrohen dhe trajtohen nga Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë.

Gjithashtu është parashikuar edhe zhvillimi i veprimtarisë së vlerësimit të nxënësve të ekselencës, sikurse në katër vitet e mëparshme. Fondi i parashikuar për shpërbimin e nxënësve ekselentë 300,000 lekë.

Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 94,711,000 lekë, dhe zënë 15.5 % të buxhetit të programit AC102.

Shpenzimet e vitit 2026 të programit AC102 Arsimit & Kujdesi Social 212,356,900 lekë do të financohen :

- ✓ 212,356,900 lekë nga Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme
- ✓ 6,362,134 lekë nga Transferta sektoriale për arsimin parashkollor dhe parauniversitar
- ✓ 302,125,449 lekë nga Të ardhurat e veta

Për vitin 2026 shpenzimet e planifikuara të këtij programi janë 554,671,000 lekë, nga të cilat shpenzime korrente 524,471,000 lekë dhe shpenzime kapitale 30,200,000 lekë.

Për vitin 2027 shpenzimet e planifikuara të këtij programi janë 556,003,000 lekë, nga të cilat shpenzime korrente 530,803,000 lekë dhe shpenzime kapitale 25,200,000 lekë.

Shpenzimet analitike për mallra e shërbime dhe të tjera korrente të programit AC102 në lekë

Artikulli	Emertimi	Parashikimi 2026
1. Drejtoria e Arsimit - Totali i shpenzimeve të tjera korrente		71,500,000
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	5,520,000
6020100	Kancelari dhe tonera	1,200,000
6020200	Materiale për pastrim dhe dezinfektim	1,200,000
6020200	Materiale për ngrohje, pelet	1,200,000
6020400	Materiale për funksion fikse zjarri	600,000
6020500	Blerje dokumentacioni	120,000
6020900	Furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme/ mjete didaktike	1,200,000
6021	Materiale dhe shërbime speciale	34,230,000
6021001	Veshje Profesionale pune	300,000

6021004	Furnizime dhe sherbime me ushqim per mencent	24,000,000
6021004	Furnizim me gaz te lengshem per gatim	1,200,000
6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	30,000
6021099	materiale te tjera (mat elektrike, hidraulike, zdrukthari,boje, lysterje, ndertimi)	7,200,000
6021099	materiale te tjera (ene guzhine,mbulesa buke,pelhura)	1,500,000
6022	Sherbime nga te trete	16,125,000
6022001	Elektricitet	7,500,000
6022002	Uje	4,000,000
6022004	Posta dhe sherbimi korrier	25,000
6022009	Sherbim dezinfektimi (DDD)	600,000
6022099	Te tjera sherbime nga te trete	4,000,000
6023	Shpenzime transporti	6,420,000
6023100	Karburant dhe vaj	6,000,000
6023200	Pjese kembimi, goma dhe bateri	300,000
6023300	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	120,000
6024	Shpenzime udhetimi	65,000
6024100	Udhetim i brendshem.	65,000
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	3,320,000
6025300	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	2,400,000
6025500	Shp. per miremb. e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes, kaldaja	500,000
6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	300,000
6025800	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	120,000
6026	Shpenzime per qiramarrje	2,364,000
6026100	Shpenzime per qiramarrje ambjentesh	2,364,000
6029	Shpenzime te tjera operative	3,456,000
6029005	Shpenzime per honorare/QKF	3,456,000
2. Qendra "Lira" - Totali i shpenzimeve te tjera korrente		7,440,000
6020	Materiale zyre	756,000
6020100	Kanceleri	70,000
6020200	Mat.per pastrim,dizifektim, ngrohje	450,000
6020300	Mat.per funksion. Pajis .te zyres	10,000
6020500	Blerje dokumentacioni	80,000
6020900	Furniz.dhe mat.te ndryshme	146,000
6021	Materiale speciale	5,094,000
6021001	Uniforma &veshje speciale	120,000
6021002	Produkte agrokulturore	35,000
6021003	Ilace &materiale mjekimi	120,000
6121004	Furnizime & sherbime per mencent	4,759,000
6021008	Materiale per mbrojtjen e tokes	10,000
6021099	Te tj. Materiale dhe sherb.specifke	50,000
6022	Sherbime nga te tretet	1,265,000
6022001	Energjia elektrike	650,000
6022002	Uje	480,000

6022003	Shpenzime telefonike, internet	120,000
6022004	Shp.post	5,000
6022099	Te tj sherbime	10,000
6023	Shpenzime transporti	95,000
6023100	Karburant dhe vaj	60,000
6023300	Shpenz. Te siguracione te mjeteve te transportit	35,000
6024	Shpenzime udhetimi	-
6024100	Udhetim e dieta	-
6025	Shpenzime per mirembajtje	170,000
6025300	Shpenz.per mirembajtje	120,000
6025400	Shpenz. Per miremb.	50,000
6029	Shpenzime te tjera operative	60,000
6029002	Shpenzime per aktivitete	60,000
3. Bashkia Berat (qendra) - Totali i shpenzimeve te tjera korrente		4,500,000
602	Shpenzime per aktivitetin "Shkolla verore 2026", dhe te tjera aktivitete ne fushen e arsimit	1,000,000
606	Persona që përfitojnë kujdesin social	3,200,000
606	Shperblim per nxenesit ekselente	300,000
Totali i shpenzimeve te tjera korrente (602-606) Programi AC102 (1+2+3)		83,440,000

Projektet e Investimeve të programit AC102 (shpenzimet kapitale në 000 lekë)

KODI	EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT	BURI I FINANCIMIT	DATA E FILLIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT	KOSTO TOTALE	2023	2024	2025	2026	2027	2028
						FAKTI	FAKTI	BUXHETI	PLANI	PLANI	PLANI
Shpenzimet Kapitale sipas Projekteve											
P912 AAR	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22Tetori" dhe parkim nëntokësor, bashkëfinancim me MAS	Financim i Brendshëm	1/1/2024	31/12/2026	181,397	0	15,016	82,470	83,911	0	0
P912 ABZ	Sistemim i ambienteve të jashtme në godinat arsimore të arsimit parauniversitar	Financim i Brendshëm	1/1/2025	31/12/2026	4,653	0	0	1,633	3,020	0	0
P912 ACB	Rikonstrukcion shkolla e mesme e bashkuar Koco Brisku në Lapardha	Financim i Brendshëm	5/3/2025	31/12/2025	15,959	0	0	15,959	0	0	0
P923 AAG	Ndërtim shkolla "Babë Dudë Karbunara", bashkëfinancim me MAS	Financim i Brendshëm	1/4/2023	31/12/2025	87,457	61,439	25,265	754	0	0	0
	Fond MFE për projektin "Fuqizimi ekonomik- shoqëror i Ballkanit Perëndimor. Mbështetje për bizneset dhe punëkërkesit";	Financim i Brendshëm									
P413 AAC			1/4/2025	31/12/2025	252	0	0	252	0	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve					289,719	61,439	40,281	101,068	86,931	0	0
Shpenzimet Kapitale sipas Produkteve											
V043 AAC	Hidroizolim Cerdhe nr.5					0	0	0	1,080	0	0

V912 AAB	Hidroizolim Kopshte		0	0	0	1,000	0	0
V923 AAB	Hidroizolim Shkolla Roshnik		0	0	0	2,700	0	0
V912 AAD	Fëmijë që Ndjekin Kopështin		0	0	0	0	25,000	0
V912 AAE	Edukatorë të Kualifikuar/Trajnuar		0	0	2,092	0	0	0
V043 AAB	Fëmijë që përfitojnë nga shërbimi social		0	0	29	500	200	200
V912 AAK	Objekte të Arsimit Bazë dhe Parashkollor të Rikonstruktura		0	0	2,139	0	0	0
V923 AAI	Konvikte të rikonstruktura		0	0	2,903	0	0	0
V043 AAC	Fëmijë që Frekuentojnë Çerdhet		0	0	500		1,000	21,500
V912 AAB	Objekte të Arsimit Baze dhe Parashkollor të Mirëmbajtura dhe Funksionale		0	0	4,111		2,500	1,500
V923 AAB	Objekte të Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale		0	0	738	2,500	1,500	2,000
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Produkteve			0	0	12,511	7,780	30,200	25,200
Totali i Përgjithshëm			61,439	40,281	113,579	94,711	30,200	25,200

DREJTORIA E ARSIMIT (NJËSI SHPENZUESE)

Drejtorja e Arsimit ka si objekt kryesor pune veprimtarinë ekonomike, financiare dhe atë të shërbimit në :

- Mirëmbajtjen e kopshteve, çerdheve, shkollave 9-vjeçare, shkollave të mesme të përgjithshme dhe konvikteve të shkollave profesionale.
- Rritjen e cilësisë së shërbimit të edukimit në kopshte dhe çerdhe që janë brenda territorit dhe juridiksionit të Bashkisë Berat.
- Shërbimin cilësor për një ushqim të shëndetshëm në kopshte, çerdhe dhe konvikte.

Drejtorja e Arsimit menaxhon produktet e tre funksioneve të rëndësishme brenda programit buxhetor AC102 , funksione të cilat financohen nga buxheti i Bashkisë Berat si edhe dhe nga grante të transfertave specifike si më poshtë :

- Arsimi bazë dhe arsimi parashkollor (09120)
- Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe konviktet (09230)
- Kujdesi për familjet dhe fëmijët (10430- çerdhet)

A. FUNKSIONI 09120 Arsimi bazë dhe arsimi parashkollor

Përshkrimi i funksionit :

- Ky funksion parashikon ndërhyrjet për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore të arsimit bazë dhe atij parashkollor, pajisjen dhe kompletimin e tyre me bazë materiale, si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme.
- Garantimin e mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve në kopshte dhe arsimin bazë.
- Shërbimin cilësor të ushqimit të fëmijëve.
- Menaxhimin financiar të Drejtorisë Arsimit që përfshin edhe shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin normal të administratës.

Politika e funksionit:

Konsiston:

- Në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies me synim arritjen e standarteve optimale bashkëkohore mësimore për fëmijët, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të shëndetshëm.
- Në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Drejtorisë së Arsimit, zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese, garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimi me efektivitet të burimeve financiare.

Përfituesit e këtij funksioni : 6,568 fëmijë/nxënës

- ✓ 34 shkolla 9-vjecare (5,531 nxënës)
- ✓ 38 kopshte (1,037 fëmijë)
- ✓ 1 Qendra Kulturore e Fëmijëve,
- ✓ 1 magazina
- ✓ 1 Godina e Shërbimeve multifunksionale në Arsim.

B. Funksioni 09230 Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe konviktet

Përshkrimi i funksionit

- Ky funksion parashikon ndërhyrjet për ndërtimin e rikonstruksionin e objekteve shkollore të arsimit të mesëm të përgjithshëm, pajisjen dhe kompletimin e tyre pjesërisht me bazë materiale dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme.
- Shërbimin cilësor të ushqimit për nxënësit konviktorë
- Gjithashtu parashikon ndërhyrjet për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme të qëndrimit të nxënësve që frekuentojnë Konviktin , kompletimin e ambienteve me bazë materiale, si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të godinave të konvikteve.

Politika e programit

- Konsiston në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies me synim arritjen e standarteve optimale bashkëkohore në Institucionet Arsimore.
- Gjithashtu konsiston në përmirësimin e infrastrukturës së konvikteve për kushte më të mira të akomodimit dhe shërbim ushqimor me cilësi.

Drejtoria e Arsimit kujdeset për 2 godina konviktesh , konvikti i Industriales dhe konvikti “Kristo Isak”. Shfrytëzohet për akomodim vetëm 1 prej tyre (konvikti “Kristo Isak”). Ky konvikt është rikonstruktuar në vitin 2019.

Përfitues të këtij funksioni : 1,497 nxënës

- ✓ 6 shkolla të mesme të bashkuara,
- ✓ 2 gjimnaze,
- ✓ 2 konvikte,
- ✓ 1,457 nxënës në shkollat e mesme
- ✓ 40 nxënës në konvikt.

C. Funksioni 10430: Kujdesi për familjet dhe fëmijët**Përshkrimi i funksionit:**

- Ky funksion parashikon ndërhyrjet në rikonstruksionin e godinave, për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme të qëndrimit të fëmijëve në çerdhe, kompletimin e tyre me bazë materiale
- Garantimin e mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve në kopshte
- Shërbimin cilësor të ushqimit të fëmijëve.

Politika e funksionit:

Konsiston në përmirësimin e infrastrukturës së kushteve të qëndrimit dhe shërbimin e ushqimit me synim arritjen e standarteve optimale bashkëkohore për fëmijët e çerdheve dhe gjithashtu kujdesi për një zhvillim të mirë psiko-emocional të fëmijëve.

Përfitues të këtij funksioni :

- ✓ 278 fëmijë të çerdheve

D. Funksioni: 7220**Përshkrimi i funksionit:**

- Ky funksion parashikon ndërhyrjet në mirëmbajtjes së institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor në territorin e Bashkisë në përputhje me standartet dhe legjislacionin në fuqi.

Politika e funksionit:

- Personel i specializuar për shërbimet në sektorin e shëndetit parësor dhe rritja sasiore e cilësore e performancës së shërbimit në qendrat shëndetësore të mirëmbajtura dhe të rikonstruktura.

Përfitues të këtij funksioni :

- Qendra Shëndetësore

Lista e institucioneve që janë në administrimin e Drejtorisë së Arsimit, Bashkia Berat

Institucionet Arsimore që marrin shërbimet nga DA janë të vendosura në **64** godina :

- ✓ 28 shkolla 9 vjecare
- ✓ dhe 38 kopshte (17 kopshte brenda shkollave dhe 21 kopshte në godina më vehte),
- ✓ 4 çerdhe (2 brenda kopshteve dhe 2 godine me vete)
- ✓ 6 shkolla të mesme të bashkuara,
- ✓ 2 gjimnaze,
- ✓ 2 konvikte,
- ✓ 1 Qendra Kulturore e Fëmijëve,
- ✓ 1 magazina,
- ✓ 1 Godina e Shërbimeve multifunksionale në Arsim.

Marrin shërbim nga Drejtoria e Arsimit 8,343 fëmijë/nxënës

- ✧ 6,568 nxënësve në kopshte + 9 vjecare
- ✧ 1,457 nxënës në shkollat e mesme
- ✧ 278 fëmijë në çerdhe
- ✧ 40 nxënës në konvikt.

U shërbehet 8,343 (nga 7,259 vitin e kaluar) nxënësve që frekuentojnë këto institucione (çerdhe, kopshte, shkolla 9-vjeçare, shkolla të mesme, konvikt).

Informacion për të gjitha Institucionet Arsimore

Numri	Njësia	Numri i shkollave	Numri i kopshteve dhe çerdheve
1	Berat 29 institucione 27 godina	7 shkolla 9- vjeçare 2 shkolla të mesme të bashkuara 2 gjimnaze të përgjithshëm 2 konvikte 1 QKF 1 magazine 1 zyra	9 kopshte 4 çerdhe
2	Roshnik 9 institucione 5 godina	4 shkolla 9- vjeçare 1 shkollë e mesme e bashkuar	4 kopshte (3 brenda shkollave)

3	Sinjë 11 institucione 5 godina	5 shkolla 9 -vjeçare 1 shkollë e mesme e bashkuar	5 kopshte (brenda shkollave)
4	Velabisht 21 institucione 13 godina	10 shkolla 9-vjeçare 1 shkollë e mesme e bashkuar	10 kopshte
5	Otlak 17 institucione 14 godina	6 shkolla 9 vjeçare 1 shkollë e mesme e bashkuar	10 kopshte
TOTAL	64 godina 87 institucione		

Tabelë përmbledhëse e listës së Institucioneve Arsimore nën administrim të Drejtorisë së Arsimit		
1	Kopshte total	38
2	Çerdhe total	4
3	Shkolla 9 vjeçare total	32
4	Shkolla të mesme total	8
5	Konvikte	2
6	Magazina	1
7	QKF	1
8	Godina e Shërbimeve multifunksionale në Arsim	1
	Total Institucione	87
	Total godina	64
	Total femijë / nxënës	8,343

Në planifikimin e Buxhetit për vitin 2026 krahasuar me 2025 janë bërë këto ndryshime të rëndësishme :

Shpenzimet e Personelit janë parashikuar me rritje bazuar në :

- VKM nr 425, datë 26.6.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”
- Vendim Nr.422, datë 26.6.2024 “Për një ndryshim në Vendimin Nr 32, Date 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave : “Për Pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.
- Rritjen e pagës minimale me 10,000 lekë në muaj, si edhe indeksim i pagës për specialistët me 5,000 lekë/muaj

Nivel i njëjtë i shpenzimeve operative

Shpenzimet operative janë parashikuar me rritje të lehtë krahasuar me 2025, me ndryshime të vogla brenda vetë strukturës. Duke u nisur nga nevojat dhe nga fakti i realizimit në 2025 disa zëra pësojnë ulje në planifikim fondesh dhe disa zëra të tjerë kanë kërkesa më të larta për fonde.

Në bazë të nevojave të parashtruara, në vitin 2026 kemi rritje të lehtë në fondin e këtyre zërave:

- Blerje mjete didaktike (shtohen nevojat për furnizime në kopshte , bashkia u dhuron fëmijëve setin e mjeteve didaktike gjithë vjetore),
- Shërbime nga të tretë (Rritje nevoja për trajnime të stafit, ekspert të jashtëm në riparime , kolaudime , projekte elektrike, ekspertiza, transport, shtim fuqie energji elektrike etj),
- Blerje materiale mirëmbajtje (Shtohen planifikimet për ndërhyrje në infrastrukturë duke parë rritjen e kërkesave dhe nevojave për mirëmbajtje si dhe në qendrat shëndetësore),
- Materiale tjera (Planifikohet të bëhet blerje uniforma për stafin teknik dhe materiale të tjera),
- Shpenzime karburanti për ngrohjen e shkollës së re 9-vjecare “22 Tetori”
- Shpenzime qeraje për sigurimin e ambienteve për nxënësit e shkollës Lapardha
- Shpenzime transporti për nxënësit e shkollës Lapardha.

Buxheti për investimet e vitit 2026

Në planifikimin e shpenzimeve kapitale për vitin 2026 janë parashikuar :

- Vazhdojnë punimet për ndërtimin e shkollës “22 Tetori”
- Vazhdojnë punimet për rikonstruksionin total të shkollës së mesme të bashkuar “Koço Korçari” Lapardha
- Ndërtim i këndit sportiv në shkollën Lapardha
- Hidrozolime në shkollë, kopshte dhe çerdhe
- Rikonstruksion pjesor i magazinës qendrore të Drejtorisë
- Blerje paisje kompjuterike për sekretaret e shkollave dhe drejtuesve të kopshteve.

QENDRA “LIRA” (njësi shpenzuese)

Misioni i Qendrës është : Zhvillim, Edukim, Integrim për pesonat me aftësi të kufizuara që marrin shërbim në Qendrën “Lira”.

Objektivi kryesor i kësaj qendre është ofrimi i shërbimeve me nivel të lartë cilësor dhe trajtimi në mënyrë profesionale për të rinjtë që jetojnë në residence, si dhe për çdo fëmijë, adoleshentë, adult që vijnë nga komuniteti dhe frekuentojnë qendrën ditore, duke ofruar përkushtim, dashuri dhe përkujdesje për këtë grup vunerabel.

Qellimi i politikës së programit:

Të sigurojë funksionimin e një sistemi cilësor dhe të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror si dhe të sigurojë akses pa barrierë për mirëqënien sociale me dinjitet, pa asnjë lloj diskriminimi, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Synimi ynë është:

- ✓ ofrimi i shërbimeve sa më cilësore dhe produktive në ecurinë e zhvillimit të fëmijëve dhe ruajtja e kapaciteteve zhvilluese që kanë adultët.

- ✓ Qëllimi final është inegrimi i fëmijëve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe përmirësimin e tyre në të gjitha fushat e zhvillimit të jetës së përditshme, për të cilat kemi rezultate konkrete.
- ✓ E rëndësishme për rezidentët është integrimi i tyre në shoqëri si pjesë e pandarë e saj, nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme .
- ✓ shërbimi që marrin nga stafi të jetë me profesionalizëm, duke ofruar përkushtim, përkujdesje dhe dashuri për këtë grup vulnerabël.

Qendra “Lira” frekuentohet nga 37 fëmijë dhe adultë që marrin çdo ditë shërbim në:

- ✓ Terapi zhvillimi
- ✓ Logopedi
- ✓ Terapi lëvizore
- ✓ Terapi ABA
- ✓ Terapi në klasën ditore

Në Rezidencën e Qendrës “Lira” ofrohet shërbim për 20 persona që jetojnë 24 orë dhe marrin shërbimin e plotë përfshirë të gjitha nevojat bazike, duke filluar që nga fjetja, ushqyerja, veshmbathjet, higjiena personale, ngrohja, medikamentet mjekësore dhe ilaçet sipas përshkrimit të mjekut, si edhe trajtimin e rasteve të emergjencës, etj.

Planifikimi i shpenzimeve operative për vitin 2026 është bërë mbështetur në përvojat e viteve të mëparshme, indeksin e rritjes së çmimeve, duke planifikuar nevojat bazike për mirëfunksionim e qendrës, duke u kujdesur që përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ta realizojmë edhe me ndihmën e donatoreve lokaël, kombëtarë e ndërkombëtarë, OJF etj.

Në mënyrë analitike shpenzime **për materiale të përgjithshme** peshën më të madhe të këtij grup shpenzimi rreth 60% të tyre, e përbëjnë materialet e higjienës dhe të pastrimit. Në plan buxhetin e shpenzimeve operative i kemi kushtuar vëmendje rritjes së shpenzimeve për mjete pastrimi dhe higjienë, pasi higjiena dhe pastërtia është primare dhe jetike në kushtet e jetesës në rezidencë dhe jo vetëm. Rritja nga 310,000 lekë të parashikuara për vitin 2025 në 450,000 lekë për vitin 2026, është e argumentuar me faktin e rritjes së numrit të rezidentëve (është shtuar me dy), efektin e rritjes çmimeve në treg, si edhe nevojës për të rritur cilësinë e shërbimeve.

Planifikimi i shpenzimeve të tjera për kancelari, blerje dokumentacioni, pothuajse është ruajtur në nivelin e buxhetit të vitit 2025. Materialet didaktike për të cilat ka shumë nevojë në qendrën ditore, janë në shifra minimale.

Në grup shpenzimet **për Materiale dhe shërbime speciale** ka një rritje prej rreth 5%, në krahasim me plan buxhetin e vitit 2025. Nga 4,487,540 lekë parashikuar në vitin 2025, në vitin 2026 parashikimi është 4,759,000 lekë. Peshën më të madhe të këtij grup shpenzimi e përbëjnë blerja e ushqimeve për rezidentët.

Të tjerë elementë në këtë grup shpenzimi janë: Blerja e veshmbathjeve për rezidentët, materiale mjekimi dhe ilaçe për rezidentët, që jepen sipas përshkrimit të mjekut, të cilat kanë pësuar një rritje të lehtë nisur nga indeksi i rritjes së çmimeve.

Në grup shpenzimet **për Shërbime ndaj të tremeve**, planifikimi për vitin 2026 ka ruajtur nivelin e shpenzimeve për energji elektike, konsum uji, shërbim interneti, shpenzime postare e shërbime të tjera me plan buxhetin e vitit 2025. Janë planifikuar në total 1,265,000 leke.

Ky grup shpenzimi përben 17% të totalit të shpenzimeve operative dhe mirembajtjes.

Në grup shpenzimet **për Shpenzime transporti** planifikimi për vitin 2026 është bërë vetëm për naftë për ngrohje me kalidajë, pasi qendra “Lira” aktualisht nuk ka mjet transporti funksional. Mjeti aktual ka plotësuar kohën e shfrytëzimit sipas normave të amortizimit dhe nuk është në gjendje pune. Jemi në diskutime me donatorë për t’i dhuruar qendrës një mjet transporti gjatë vitit 2026.

Ne grupin **shpenzime për mirembajtje** planifikimi për vitin 2026 (170,000 lek), ka ruajtur nivelin e planifikuar për vitin 2025, (170,000 lek)

Ne kete grup shpenzimi perfshihen shpenzimet për mirembajtje të zakonshme godine, si lysterje, suvatime e riparime, mirëmbajtje të rrjetit elektrik dhe hidraulik.

Planifikimi i shpenzimeve për investime, artikulli 231.

Në buxhetin e vitit 2026 kemi parashikuar 500,000 lekë për të zgjidhur disa nevoja emergjente për investime, si pajisje kuzhime, pajisje elektroshtepiake, frigorifer për magazinën dhe kuzhinën, kondicioner për qendrën ditore, si edhe pajisje zyre si dollap arkive, dollap për dhomat e rezidentëve.

Planifikimi i shpenzimeve për investime për plan buxhetin 2026, në Qendrën “LIRA”:

llog.	Emertimi	shuma ne lek
231	Pajisje elektroshtepiake (frigorifer për magazine, kuzhinën)	120,000
231	Kondicionet për Qendrën ditore	120,000
231	Pajisje zyre (Dollap rrobash dhe arkive, poltron)	260,000
	Totali 231	500,000

SHËRBIMI SOCIAL (drejtori në njësinë shpenzuese Bashkia qendër)

Në qytetin e Beratit si edhe në Njësitë Administrative Velabisht, Sinjë, Otlak, Roshnik, funksionojnë Zyrat përkatëse të ofrimit të shërbimeve sociale për: Ndhmën Ekonomike, Pagesën e Paaftësisë, Invaliditetit.

Në qytetin e Beratit ofrohet gjithashtu shërbim në dy Qendra Rezidenciale dhe një Ditore, Qendra Komunitare, si dhe shërbime të tjera në NJMF dhe dhuna në familje për grupe me nevoja të veçanta (fëmijë, gratë e dhunuara, mosha e tretë).

Drejtorja e Shërbimit Social ka një staf prej 17 punonjës, specialistë me arsim të lartë e profesionistë të aftë për t'i shërbyer komunitetit.

Objektivat e Drejtorisë së Shërbimit Social në bashkinë Berat :

- ✓ Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Shërbimit Social është objektivi kryesor i punës së përditshme të Drejtorisë.
- ✓ Orientimi i punës drejt identifikimit, trajtimit edhe përmes adresimit të problemeve, të familjeve në kushtet e varfërisë ekstreme, grave në nevojë, fëmijëve të pambrojtur, personave të moshës së tretë, jetimëve, romëve, egjiptianëve me synim zbutjen e problemeve të tyre dhe fuqizimin e kategorive të sipërpërmendura.
- ✓ Të përcaktoje sipas ligjit ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale për ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

- ✓ Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.
- ✓ Mbrojtje të vecantë të të drejtave të fëmijëve nëpërmjet marrjes së masave për t'u siguruar ushtrimin e të drejtave të tyre brenda kuadrit ligjor, bashkëpunimit midis strukturave dhe autoriteteve qendrore e lokale.
- ✓ Informimi dhe ndërgjegjësimi për lehtësirat tatimore vendore të grupeve : përfituesit e ndihmës ekonomike, invalidët e punës, para-tetra plegjikët, të verbër, familje me një person kryefamiljar (të moshuarit e vetmuar, kryefamiljarët si I/E ve, të divorcuar).
- ✓ Përfshirja nga tarifa mujore e pagesës ushqimore në kopshte/çerdhe të fëmijëve prej: komunitetit rom/egjiptian, fëmijë të familjarëve përfitues të ndihmës ekonomike, të nënave kryefamiljare, fëmijë me aftësi ndryshe dhe të diagnostikuar me sëmundje terminale, të vërtetuar nga KMCAP.
- ✓ Mbështetja dhe subvencionimi i strehimit për dy grupe: familje pa të ardhura ekonomike ku përfshihen, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe personat që trajtohen me pagesën e aftësisë së kufizuar dhe familje me të ardhura të ulëta.

Të dhëna bazë mbi programin AC102 Arsimi & Kujdesi Social

		FUNKSIONI	TË PËRGJITHSHME	2021	2022	2023	2024	2025
1	NUMER PUNONJESISH NE KOPSHTË	09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	0	114	114	114	114	114
2	NUMER PUNONJES MBESHTETES NE QYTET	09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	0	100	100	100	100	100
3	NUMER PUNONJESISH NE CERDHE	10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	0	38	41	41	41	41
4	NUMER PUNONJESISH NE KONVIKT	09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm	0	14	14	14	14	14
5	NUMER PUNONJESISHT ADMINISTRATA	09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	0	11	12	12	12	18
6	NUMER PUNONJESISHT SEKTORI TEKNIK	09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	0	13	13	13	13	21
7	NUMER PUNONJES MBESHTETES NE NJESITE ADMINISTRATIVE	09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	0	20	23	23	23	23
8	NUMER PUNONJESISH NE SEKTORIN E USHQIMIT	09120 - Arsimi bazë përfshirë	0	17	16	17	17	17

		sistemin e arsimit parashkollor						
9	FEMIJE QE FREKUNTOJNE CERDHET	10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	0	180	200	200	200	278
10	FEMIJE QE FREKUNTOJNE KOPSHTET	09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	0	1,090	1,000	1,000	1,000	386
11	KUZHINA QE OFROJNE SHERBIMIN E USHQIMIT	09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	0	5	5	5	5	5
12	KUZHINA QE OFROJNE SHERBIMIN E USHQIMIT	10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	0	3	3	4	4	4
13	KUZHINA QE OFROJNE SHERBIMIN E USHQIMIT	09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm	0	1	1	1	1	1
14	NUMER PUNIMESH PER MIREMBAJTJE NGA STAFI TEKNIK	09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	0	500	500	550	600	600
15	NUMER PUNIMESH PER MIREMBAJTJE NGA STAFI TEKNIK	10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	0	80	80	90	100	100
16	NUMER PUNIMESH PER MIREMBAJTJE NGA STAFI TEKNIK	09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm	0	80	85	90	100	100
